

1 E enjte, 4 nëntor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 --- Seanca fillon në orën 09.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes
5 të gjithëve.

6 Znj. Sekretare paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda
8 numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni
9 Gucati dhe Nasim Haradinaj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Tani do t'u kërkoj palëve të prezantohen. Do të filloj me
12 Prokurorinë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
14 Mirëmëngjes të gjithëve.

15 Sot për Prokurorinë janë Valeria Bolici, Prokurorja; Matt
16 Halling, Ndihmës Prokuror, Line Pedersen, Administratore e
17 Lëndës dhe e Provave; dhe James z. Pace, Ndihmës Prokuror.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Rees.

20 Z. REES: [Përkthim] Unë jam Jonathan Rees, QC, përfaqësoj
21 z. Gucati. Sot me mua këtu janë znj. Faye Wigmore, z. Joseph
22 Bowden.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

24 z. Rees.

25 Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Toby Cadman për
2 z. Nasim Haradinaj, ndihmuar nga z. Carl Buckley, z. Jonathan
3 Worboys, znj. Poppy Henderson, znj. Chelsea Qu dhe Admir
4 Berisha.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 Gjithashtu vē re se z. Gucati dhe z. Haradinaj janë të
7 pranishēm në sallën e gjyqit. Sot do të vazhdojmē me dëshminē
8 e z. Jukiç.

9 Znj. Ndhmēse e Gjykatēs, ju lutem sillni dëshmitarin.

10 [Dëshmitari vijon dëshminē]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirēmēngjes,
12 z. Jukiç, mund të uleni.

13 Për hir të procesverbalit, Prokuroria javën e kaluar
14 pērfundoi pyetjet për dëshmitarin. Dhe sot do të fillojë me
15 pyetjet e veta Mbrojtja.

16 Z. Rees, z. Cadman, keni pasur kohē të mjaftueshme për të
17 pērgatitur pyetjet. Sa mendoni se do t'ju duhet për t'i bērē
18 kēto pyetje?

19 Z. Rees.

20 Z. REES: [Përkthim] Mendoj që do të na duhet seanca e
21 mēngjesit. Ndoshta do të vazhdoj deri nga koha e drekēs dhe
22 besoj që do të pērfundojë në pjesën e parē të seancēs sē tretē
23 dhe të fundit për sot.

24 Z. Cadman.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unē nuk mendoj që do të kaloj

1 ditën sot varësisht nga ajo që do të pyesë z. Rees, sepse kemi
2 pyetje të njëjta dhe sikurse kemi thënë do të përpiqemi të
3 përfundojmë sot.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Prokuror, a ju kam kuptuar drejt nga parashtrimi juaj
6 se Dëshmitari i ardhshëm është i gatshëm të fillojë me
7 dëshminë sapo të përfundojë ky dëshmitar me dëshminë e vet?

8 Z. PACE: [Përkthim] Po, mendoj që do të mund të filloj
9 nesër në mëngjes, mirëpo n.q.s. duhet të filloj sot, mund ta
10 bëjmë edhe këtë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Atëherë vazhdojmë me z. Jukiç.

13 Z. Rees, e keni fjalën për pyetjet e Mbrojtjes.

14 DËSHMITARI: MIRO JUKIÇ [vijon]

15 Pyetje të palës tjetër nga Z. Rees:

16 Py. Z. Jukiç, një përmbledhje të shkurtër për ato që na
17 thatë javën e kaluar.

18 Ju u bëtë oficer për sigurinë e dëshmitarëve në zyrën e
19 ZPS-së në shtator 2019, kështu?

20 Pë. Po.

21 Py. Dhe në atë detyrë mbetët deri në prill të vitit 2021 kur
22 u bëtë udhëheqës i ekipit për sigurinë dhe trajtimin e
23 dëshmitarëve, kështu?

24 Pë. Po, e saktë.

25 Py. Deri në mesin e tetorit 2020, detyrën e kryente një

1 udhëheqës tjetër i ekipit për sigurinë dhe trajtimin e
2 dëshmitarëve, kështu?

3 Pë. Ai ishte në atë detyrë deri më datën 31 dhjetor 2020.

4 Py. Dhe pse ai e la atë post?

5 Pë. Ai u largua për shkak të Brexit-it meqë ishte shtetas i
6 Britanisë së Madhe.

7 Py. D.m.th. ai jo vetëm që e la postin, por e la edhe
8 punësimin me ZPS-në, kështu?

9 Pë. Po, e saktë.

10 Py. A mund të na shpjegoni pak më shumë se çfarë lidhje ka
11 Brexit-i me largimin e tij?

12 Pë. Për arsye se shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar duhej të
13 largoheshin nga organizata përpara 1 janarit 2021.

14 Py. A nuk keni punonjës të Britanisë së Madhe në ZPS?

15 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që pyetja
16 nuk lidhet me çështjen.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhëroni z.
18 Rees.

19 Z. REES: [Përkthim] Dua që të përcaktoj kredibilitetin e
20 përgjigjes se Brexit-i ishte arsyeja për largimin e këtij
21 personi nga detyra e udhëheqësit të ekipit për sigurinë e
22 dëshmitarëve.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E
24 kundërshtoj. E hedh poshtë kundërshtimin.

25 Vazhdoni z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] Ai i ka ikur detyrimit të Brexit-it
2 apo jo?

3 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është pyetje, i nderuar Gjykatës?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranoj
5 kundërshtimin.

6 Z. REES: [Përkthim]
7 Py. Po si një punonjës i ZPS-së t'i largohet detyrimit të
8 Brexit-it?

9 Z. REES: [Përkthim] A ka ndonjë kundërshtim që unë të
10 përdor emrin e një punonjësi të mëparshëm?

11 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim meqë është një
12 punonjës i përparshëm.

13 Të nderuar Gjykatës, dëshmitari nuk është përfaqësues i
14 burimeve njerëzore dhe nga ai kërkohet të spekulojë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund njëherë
16 ta pyetni nëse ai ka një farë dijeni për këtë.

17 Z. REES: [Përkthim]
18 Py. A keni njohuri dëshmitar, sepse një anëtar i stafit i
19 mëparshëm që ka qenë britanik në ZPS i është shmangur pasojave
20 të Brexit-it siç thoni që ka bërë [REDAKTUAR]?

21 Pë. Nuk di për këtë.

22 Py. [REDAKTUAR] paraqitet, pra emri i tij paraqitet në
23 shënimet për kontaktet që keni pasur me dëshmitarë dhe që janë
24 nxjerrë deri tani, për afërsisht më datën 14 tetor dhe pas asaj
25 dikund pas datës 14 tetor. A ka qenë ai aktiv deri në javën e

1 tretë të dhjetorit?

2 Pë. Ai ka qenë aktiv deri më 31 dhjetor. Mirëpo duke qenë se
3 kishte shumë ditë të lira pushimi ai përdori disa prej tyre.

4 Py. Dhe më pas së paku për tre muaj pozita e udhëheqësit të
5 ekipit për mbrojtjen dhe trajtimin e dëshmitarëve ishte e lirë
6 apo jo?

7 Pë. Po.

8 Py. Ju asnjëherë s'keni punuar si hetues me ZPS-në; a është
9 kështu?

10 Pë. Po.

11 Py. Detyrat tuaja nuk kishin të bëjnë me përfshirjen në
12 hetime; a është kështu?

13 Pë. Po.

14 Py. Përgjegjësitë tuaja aktuale sidoqoftë përfshijnë detyrën
15 e këshilltarit të Zëvendësprokurorit të Specializuar; a është
16 kjo e saktë?

17 Pë. Po.

18 Py. Në lidhje me çështjet që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen
19 e dëshmitarëve, kur filluat detyrën e këshillimit të
20 Zëvendësprokurorit të Specializuar?

21 Pë. U caktova si kryes i detyrës së udhëheqësit të ekipit më
22 1 janar, 2021.

23 Py. Dhe përpara kësaj date, ju po thoni se nuk keni pasur
24 detyrën e këshilltarit për Zëvendësprokurorin e Specializuar;
25 a është kështu?

1 Pë. Po, e saktë.

2 Py. Nga ajo kohë a keni bashkëpunuar ngushtë me

3 Zëvendësprokurorin e Specializuar?

4 Pë. Po.

5 Py. Sa shpesh takoheni me të?

6 Pë. Pothuajse çdo ditë.

7 Py. Dhe kështu ka qenë që nga 1 janari apo jo?

8 Pë. Po, e saktë.

9 Py. Përpara datës 1 janar, a jeni takuar në aspektin
10 profesional me Zëvendësprokurorin e Specializuar?

11 Pë. Po.

12 Py. Sa shpesh?

13 Pë. Kur kam qenë në zyrë, pothuajse çdo ditë.

14 Py. Po, në lidhje me kohën përpara datës 7 shtator 2020, a e
15 keni takuar atëherë Zëvendësprokurorin e Specializuar?

16 Pë. A e keni takuar në atë fazë, në atë periudhë kohore
17 pothuajse çdo ditë?

18 Pë. Jo.

19 Py. Po gjatë shtatorit të vitit 2020, a e keni takuar atë?

20 Pë. Jo.

21 Py. Supozohet se për një oficer të sigurisë së dëshmitarëve
22 kontakti i drejtpërdrejtë me dëshmitarët nuk është diçka e
23 jashtëzakonshme apo jo?

24 Pë. A është kjo pyetje?

25 Py. Po, është pyetje. Më falni, do ta bëj më të thjeshtë. A

1 pajtoheni me mua se kontakti i drejtpërdrejtë me dëshmitarë
2 nuk është një gjë e jashtëzakonshme për një oficer të sigurisë
3 së dëshmitarëve?

4 Pë. Kontakti i drejtpërdrejtë me dëshmitarët është një pjesë
5 e punës së një oficeri të sigurisë së dëshmitarëve.

6 Py. Dhe pjesë e rolit të tyre është të mbajë kontaktin me
7 dëshmitarët apo jo?

8 Pë. Po, pajtohem.

9 Py. Po një oficeri të sigurisë së dëshmitarëve a i jepen atij
10 përgjegjësi për një numër të caktuar dëshmitarësh?

11 Pë. Po. Këta oficerë janë përgjegjës për një numër të caktuar
12 dëshmitarësh.

13 Py. Pra, atyre ju jepet një grup apo ekip dëshmitarësh me të
14 cilët ata duhet të mbajnë kontakt dhe për të cilët ata janë
15 përgjegjës, a është kjo e saktë?

16 Pë. Po.

17 Py. Dhe a është pjesë e rutinës së punës që dëshmitarëve t'ju
18 jepet një numër për të kontaktuar ZPS-në, apo jo?

19 Pë. Po, është e saktë.

20 Py. Ky nuk është një numër i veçantë për çështje që lidhen me
21 sigurinë, por është thjesht një numër të cilin dëshmitarët
22 mund ta përdorin për të gjitha çështjet që lidhen me ZPS-në,
23 apo jo?

24 Pë. Po, e saktë.

25 Py. Na thatë se kontaktimi i dëshmitarëve më pas dokumentohet

1 në një Notë Zyrtare pas çdo telefonate, a është e saktë?

2 Pë. Po, e saktë.

3 Py. Dhe ju konkretisht na thatë se ju i keni mbajtur shënim
4 të gjitha kontaktet në një shënim zyrtar menjëherë pas
5 telefonatës; a është kështu?

6 Pë. Po, e saktë.

7 Py. Na shpjeguat në mënyrë jo-kontraverse se është shumë e
8 rëndësishme që të mbahet një shënim i saktë në lidhje me të
9 gjithë kontaktet me dëshmitarët. Ju përmendët fjalën "të
10 ndiqet dëshmitari" në kuptim të mbajtjes së evidencës, a është
11 kështu?

12 Pë. Po.

13 Py. Në shtator të vitit 2020, ju ishit në Kosovë. A keni qenë
14 në Kosovë, më falni, gjatë ndonjë momenti në atë muaj?

15 Pë. Po.

16 Py. A mund të na i thoni datat se kur keni qenë në Kosovë?

17 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj rëndësinë e këtij detaji
18 specifik, sepse dëshmitari mund të punojë edhe në lidhje me
19 çështje të tjera.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet poshtë
21 kundërshtimi.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk i datat e sakta kur në
23 shtator, por ishte në pjesën e parë të shtatorit.

24 Z. REES: [Përkthim]

25 Py. A keni qenë në Kosovë, në ditët m'u përpara mbajtjes së

1 konferencës së parë dhe gjatë vetë konferencës së parë, më 7
2 shtator, 2020?

3 Pë. Po, kam qenë në Kosovë, në atë datë.

4 Py. Po në ditët përpara dhe gjatë vetë konferencës së dytë më
5 16 shtator?

6 Pë. Jo, nuk kam qenë në Kosovë në ato data.

7 Py. Po në ditët përpara mbajtjes së konferencës së tretë dhe
8 gjatë vetë konferencës?

9 Pë. Jo, nuk kam qenë në Kosovë në ato data.

10 Py. A mund na ndihmoni në lidhje me praninë e pjesëtarëve të
11 tjerë të ZPS-së në Kosovë gjatë atij muaji?

12 Z. PACE: [Përkthim] Dëshmitarit po i bëhet pyetje se kush
13 ka qenë në Kosovë në atë kohë. Ne duhet ta dimë sepse është
14 kjo e rëndësishme dhe pse kërkohen të dhëna konkrete të tilla.

15 Z. REES: [Përkthim] Më duhen disa emra përpara se të
16 paraqes rëndësinë e pyetjes që kam.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
18 hidhet poshtë, mirëpo do të kalojmë njëherë në seancë private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.

9 Py. A ka përfaqësues të përhershëm të ZPS-së në Prishtinë?

10 Pë. Nuk kemi zyrë në Prishtinë dhe nuk kemi përfaqësues të
11 përhershëm të zyrës tonë në Prishtinë.

12 Z. REES: [Përkthim] Do të kaloj tek disa emra pas pak
13 kohe. Mund të kalojmë në seancë publike njëherë dhe pastaj
14 përsëri në seancë private ose mund të mbetemi edhe në seancë
15 private. Si të vendosni ju i nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'i
17 përmendni emrat tani apo?

18 Z. REES: [Përkthim] Duhet njëherë të krijoj sfondin për
19 këtë pyetje dhe pastaj do t'i bëj pyetjet në lidhje me emrat.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë të
21 kalojmë në seancë publike.

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në
25 seancë publike.

1 Vazhdoni z. Rees.

2 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

3 Py. Tani z. Jukiç, ju i keni dhënë ZPS-së një deklaratë.

4 Deklarata mban datën 27 tetor, 2020. Dhe atë dokument e keni
5 futur në sistem po atë ditë; a është kjo e saktë?

6 Pë. Nuk më kujtohet.

7 Py. Po qe se e shikojmë dokumentin.

8 Z. REES: [Përkthim] Ka numrin ERN 084008 deri në 084010.

9 Py. Mund të shohim se ky dokument mban vetëm një datë, aty në
10 fund të dokumentit është data 27 tetor.

11 Pë. Po, e saktë.

12 Py. Atëherë, nga fakti që nuk ka një datë të mëpasshme del që
13 dokumentin e keni futur në sistem po atë ditë.

14 Pë. E kam nënshkruar deklaratën atë ditë. Nuk më kujtohet se
15 kur e kam dorëzuar në sistem.

16 Py. Kur e keni dorëzuar dokumentin në ZyLAB, ZyLAB
17 automatikisht nuk i vendos një datë dokumentit apo jo?

18 Pë. Nuk jam ekspert në atë fushë, nuk mund t'ju them.

19 Py. Ju na ndihmuat javën që shkoi me datat në disa dokumente,
20 prandaj me sa mundeni, a mund të na konfirmoni që dorëzimi i
21 dokumenteve në ZyLAB nuk do të thotë që në ZyLAB automatikisht
22 krijohet një datë që konfirmon dorëzimin e dokumentit.

23 Z. PACE: [Përkthim] Dëshmitari, të nderuar Gjykatës tha
24 se nuk është ekspert në këtë fushë dhe se nuk mund të thotë
25 asnjë gjë në lidhje me këtë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 përgjigjeni. Kundërshtimi hidhet poshtë.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Me Notën Zyrtare është ndryshe,
4 duhet njëherë ta printoj dhe t'i vendos një datë dhe pasi ta
5 kem printuar së bashku me faqen e parë ta dorëzoj në ZyLAB.
6 Atëherë ku është dallimi midis dorëzimit të Notës Zyrtare dhe
7 dorëzimit të një deklaratë?

8 Pë. Për Notat Zyrtare kemi një formular model.

9 Py. Dhe një formular i tillë, a ka ndonjë kuti për datën se
10 kur është krijuar dokumenti dhe ndonjë vend tjetër se kur
11 është dorëzuar në ZyLAB?

12 Pë. Ne punojmë në Kosovë. Kur jam në Kosovë, unë i përgatis
13 të gjitha shënimet dhe pastaj i dorëzoj ato kur kthehem në
14 zyrë. Dhe kështu ka ndodhur me të gjitha shënimet zyrtare.

15 Py. Mirëpo ju keni qenë në zyrë më datën 27 tetor sepse mund
16 ta shohim nga dokumenti që është krijuar në Hagë, në Holandë.
17 E shikoni këtë?

18 Pë. Po, kam qenë në zyrë në atë datë.

19 Py. Faleminderit. Ju e keni vënë datën 27 tetor në dokument
20 dhe supozojmë që dokumentin e keni dorëzuar në sistem po atë
21 ditë apo jo?

22 Pë. Mendoj që po.

23 Py. Dhe ju keni bërë një deklaratë të dytë me datën 27 janar
24 2021.

25 Z. REES: [Përkthim] Dokumenti ka numrin ERN 090142 deri

1 në 090143. Ta shikojmë shkurtimisht faqen e fundit të
2 dokumentit.

3 Py. Mund të shohim nga dokumenti se data është 27 janar 2021
4 dhe është e vetmja datë në dokument dhe supozojmë që kjo është
5 data kur e keni dorëzuar dokumenti në ZyLAB.

6 Pë. Po.

7 Py. Dhe dokumenti tregon se keni qenë në Hagë në atë datë;
8 apo jo?

9 Pë. Po, e saktë.

10 Py. Të kalojmë në seancë private në përputhje me vendimin e
11 mëparshëm të Trupit Gjykses.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
13 seancë private.

14 ~~{Seancë private}~~ *Riklasifikuar si publike dhe*
përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private
16 të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Jemi në seancë private.

19 Z. Rees mund të vazhdoni.

20 Z. REES: [Përkthim]

21 Py. Javën që shkoi na thatë se në shtator morët disa
22 telefonata nga dëshmitarë që ishin të shqetësuar për faktin që
23 emri i tyre ishte i bërë publik në mediat në Kosovë. Do t'ju
24 bëj pyetje në lidhje me disa emra sepse ka një listë emrash të
25 përmendur në media dhe do t'ju kërkoj që të konfirmoni nëse i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) ~~(Seancë private)~~

Faqe 18

Riklasifikuar si publike në F611/A3.

Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

1 dini ato emra. Pra këto emra të publikuar në media, a janë
2 emrat e atyre që ju kanë bërë telefonatë dhe që ju kanë
3 shprehur shqetësime.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pyetja nuk është
5 me vend. Mbrojtësi e di shumë mirë se emrat e personave që
6 kanë kontaktuar ZPS-në janë të dokumentuar dhe janë të nxjerra
7 në Shënimin Zyrtar dhe disa prej tyre janë të redaktuara.

8 Z. REES: Unë nuk po bëj këtu pyetje anësore. Unë vetëm po
9 lidhem vetëm me atë që tha dëshmitari javën e kaluar.

10 Ne e dimë, i dimë emrat që janë bërë publikë sepse ato
11 emra, ato publikime kanë qenë edhe në atë kohë publike dhe
12 janë të tilla edhe sot.

13 Dua thjesht ta pyes dëshmitarin n.q.s. ndonjë prej emrave
14 të publikuar në media - dhe unë do t'i përmend një nga një ato
15 - kanë qenë ndër ata që e kanë kontaktuar këtë dëshmitar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju përpara
17 thatë se mund t'i bëni një pyetje të përgjithshme dëshmitarit
18 pa i përmendur emrat e personave që i kanë bërë telefonatë. Më
19 së pari mund ta bëni atë pyetje të përgjithshme.

20 Z. REES: [Përkthim] Po ai iu përgjigj asaj pyetjeje. Ai
21 ka thënë se:

22 "Kemi marrë disa telefonata nga dëshmitarët konkretë të
23 cilët, emrat e të cilëve ishin publikuar në mediat në Kosovë".

24 N.q.s. shkoj me listën e emrave dhe ai thotë që asnjë
25 prej këtyre personave nuk janë ata që na kanë bërë telefonata,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) ~~(Seancë private)~~

Faqe 19

Riklasifikuar si publike në F611/A3.

Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

1 atëherë kredibiliteti i personave që kanë bërë telefonatat
2 vihet në dyshim, duke qenë se emrat e tyre nuk kanë qenë të
3 publikuar në media. Prandaj nuk e shoh se ku është thelbi i
4 kundërshtimit të Prokurorisë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çdo emër që
6 ju do ta përmendni tani tashmë është përmendur në
7 procesverbal?

8 Z. REES: [Përkthim] Po.

9 Z. PACE: [Përkthim] Dua të ma jepni fjalën i nderuar
10 Gjykatës.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 dëgjoheni. Mund të flisni tani z. Pace.

14 Z. PACE: [Përkthim] Thjesht dua të them që nga
15 kundërshtimi duket qartë se përpjekja e bërë është ose e
16 qëllimtare ose ka synim t'i bëjë bisht urdhrin të dhënë për
17 mosnxjerrje materiale. Me sa mbaj mend unë, dëshmitari nuk
18 ka thënë që mban mend të gjithë emrat e personave që kanë
19 kontaktuar zyrën. Kështu që nuk e kuptoj se ç'kuptim ka që t'i
20 përmend të gjithë listën e dëshmitarëve përveçse për të qenë
21 një lloj ushtrimi për të parë nëse dëshmitari i mban mend
22 emrat.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në
24 seancë private. Pyetja që z. Rees ka propozuar është me
25 rëndësi dhe do të lejohet.

1 Vazhdo, z. Rees.

2 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.

15 Py. Të gjithë këta emra sigurisht ishin përmendur më herët në
16 publikime të mediave dhe në fakt ishin persona që kërkoheshin
17 nga Interpoli për krime të kryera në Kosovë. Kjo për ju, ju
18 thotë diçka kjo? Kishit ndonjë dijeni për këtë?

19 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj rëndësinë e kësaj
20 pyetjes.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
22 përgjigjeni pyetjes nëse keni ndonjë dijeni për këtë.

23 Z. PACE: [Përkthim] Më vjen keq që kundërshtoj përsëri po
24 sapo për të provuar se ka një themel kjo pyetje për këtë
25 pohim. Unë nuk e di. Nuk është ndonjë fakt i diskutueshëm,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) ~~(Seancë private)~~

Faqe 24

Riklasifikuar si publike në F611/A3.

Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

1 kështu që përpara se t'i paraqitet dëshmitarit si një fakt i
2 vërtetuar, të dëgjojmë se ku mbështetet.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari, dua
4 që dëshmitari t'i përgjigjet pyetjes.

5 Keni ndonjë dijeni për këtë?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo nuk kam asnjë dijeni.

7 Z. REES: [Përkthim] Baza ku mbështetemi ne është
8 artikulli i gazetës që ZPS-ja vetë e ka prodhuar si provë dhe
9 aty ka pamje të Interpolit, të materialeve të ndryshme. Aty
10 përmendet Interpoli dhe emrat e tyre.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra pyetja
12 përgatitore, ai tha që nuk ka dijeni.

13 Z. REES: Do të bëjmë një pyetje tjetër në vijim. N.q.s.
14 ju kujtohet, ne e pyetëm znj. Pumper dhe ju me të drejtë më
15 thatë se çështja është nëse ka pasur ndonjë bashkëpunim midis
16 ZPS-së dhe Interpolit dhe për këtë kërkohen prova, dëshmi. Dhe
17 unë po e pyes z. Jukiç nëse ka ndonjë dëshmi apo ndonjë provë
18 që ZPS-ja t'i ketë dhënë prova Interpolit për personat e
19 kërkuar.

20 Z. Jukiç a keni ndonjë informacion apo dijeni që ZPS-ja i
21 ka dhënë informacion për vendndodhjen e personave me të cilët
22 ZPS-ja ka qenë në kontakt, t'ia ketë dhënë Interpolit këtë
23 informacion për faktin që ishin persona të kërkuar në Kosovë
24 për krimet e kryera në Kosovë?

25 Pë. Nuk kam asnjë informacion, asnjë dijeni për këtë.

1 Py. Sigurisht ju thoni që një punonjës i sigurisë së
2 dëshmitarëve dhe që ka ca kohë në këtë punë dhe që nga janari
3 ishte shefi në detyrë i ekipit, pra ekipi juaj duhet të ketë
4 pasur dijeni, informacion me personat që keni pasur kontakt?

5 Pë. Ekipi im nuk ka dijeni për këtë.

6 Py. Ka apo nuk ka?

7 Pë. Nuk ka.

8 Py. Atëherë si i mbani ju kontaktet me personat kur ekipi
9 juaj nuk ka informacion se ku ndodhen këta persona, kontaktet
10 e tyre, adresat e kështu me radhë?

11 Z. PACE: [Përkthim] Mbase mund ta bëj të qartë se te cili
12 dëshmitar e ka fjalën Mbrojtësi? Ne kishim vetëm një pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është një
14 pyetje shumë e gjerë. Duhet ta ngushtoni.

15 Z. REES: [Përkthim]

16 Py. Pra zyra juaj, ekipi juaj thotë se hollësitë e kontaktit,
17 numrat e telefonave, adresat e personave me të cilët ZPS-ja ka
18 qenë në kontakt si dëshmitarë të mundshëm; këtë po thoni?

19 Pë. Po.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z.

7 Rees, jemi në seancë publike.

8 Z. REES: [Përkthim]

9 Py. Sikundër sapo e trajtuam pjesërisht mund të them se është
10 e drejtë që nga përvoja juaj, disa dëshmitarë u nxorën, e
11 nxorën vetë publikisht me vullnetin e tyre se janë dëshmitarë;
12 është kështu?

13 Pë. Po.

14 Py. Dhe kanë plotësisht të drejtë, por disa prej tyre nuk
15 kanë pranuar ndihmë nga ana juaj; apo jo?

16 Pë. Ashtu është edhe kjo.

17 Py. Besoj që ka mënyra të ndryshme, sesi mund t'i ndihmoni ju
18 dëshmitarët që me vullnetin e vet e kanë bërë të njohur
19 publikisht se janë dëshmitarë, për shembull, mund t'i ndihmoni
20 me udhëtimin e tyre; apo jo?

21 Pë. Po, është e saktë.

22 Py. Mund t'i ndihmoni me akomodim, me strehimin n.q.s.
23 nevojitet?

24 Pë. N.q.s. më lejoni, dua ta bëj ta qartë. Po më pyesni për
25 dëshmitarët që vijnë në Hagë për t'i dhënë deklarata ZPS-së?

1 Py. Është një shembull, për shembull që ju si zyrë mund ta
2 ndihmoni një dëshmitar, sepse ata largohen nga vendi i tyre i
3 zakonshëm, vendbanimi i tyre i zakonshëm apo jo?

4 Pë. Po, ashtu është.

5 Py. Dhe megjithatë prapë mund t'i ndihmoni, për shembull,
6 duke ju dhënë disa ta holla për shpenzime.

7 Z. PACE: [Përkthim] Është një pyetje shumë e
8 përgjithshme. Dëshmitari kërkoi sqarim. N.q.s. është një
9 çështje konkrete për të cilën Mbrojtja kërkon sqarim, mund t'i
10 bëhet pyetje dëshmitarit sepse "koncepti i shpenzimeve" është
11 shumë i gjerë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet.
13 Mund ta ndihmoni [sipas përkthimit].

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, i ndihmojmë edhe me shpenzime.

15 Z. REES: [Përkthim]

16 Py. Kur dëshmitari e ka bërë të qartë publikisht vetë se
17 është dëshmitar, megjithatë ju prapë e ndihmoni me mbrojtje
18 fizike, n.q.s. më pas kërcënohen, kështu?

19 Pë. Po, nëse kërcënohen i ndihmojmë.

20 Py. Por ajo që ju nuk e bëni dot, kur dëshmitari e ka bërë
21 publike vetë se është dëshmitar, është që ta ktheni pas një
22 njohuri të tillë, ta përmbysni. Nuk mund t'ia mbronni më
23 konfidencialitetin e tyre kur e bëjnë publike se janë të
24 tillë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Është një pyetje shumë argumentative.

1 Nuk e di është pyetje apo është deklaratë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [mikrofoni i Gjykatësit
3 është i çaktivizuar]

4 Z. REES:

5 Py. Ishte një vendim që u mor për thirrjen e një personi që
6 përmendej në atë që është etiketuar si znj. Pumper, Paketa 1,
7 2, 3, edhe unë po e quaj këtë kështu shkurtimisht. Pra një
8 person u mor vendim për ta thirrur vetëm pas konferencës së
9 tretë të mbajtur në 22 shtator 2020; kështu?

10 Pë. Po.

11 Py. Nuk u ndërmor ndonjë veprim konkret nga ekipi i mbrojtjes
12 dhe trajtimit të dëshmitarëve mbas konferencës së shtypit të 7
13 shtatorit 2020; kështu?

14 Pë. Jo, nuk u mor asgjë.

15 Py. Dhe nuk u ndërmor asnjë veprim konkret nga ekipi juaj pas
16 11 shtatorit [sipas përkthimit]?

17 Z. PACE: [Përkthim] Lidhur me këto pyetje, për veprime
18 konkrete a mund të bëhet më konkret sepse mund të jenë të
19 ndryshme "veprimet konkrete".

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. Të
21 jeni më konkret ç'keni parasysht me këto fjalë.

22 Z. REES: [Përkthim]

23 Py. A u ndërmor ndonjë veprim që erdhi si rezultat i
24 konferencës së shtypit të 16 shtatorit, i ndërmarrë nga ekipi
25 i trajtimit dhe i mbrojtjes së dëshmitarëve?

1 Pë. Jo, nuk pati.

2 Py. Pra ajo që ndodhi në 7 dhe 16 tetor nuk ishte me
3 përparësi të madhe për zyrën deri në konferencën e 22
4 shtatorit 2020.

5 Z. PACE: [Përkthim] Është prapë argumentative më shumë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

7 Z. REES: [Përkthim]

8 Py. Ju iu referuat planit të 24 shtatorit në dëshminë tuaj si
9 diçka me përparësi të madhe për zyrën tuaj, prandaj unë po ju
10 pyes nëse zyra e mori parasysh atë që ndodhi në 7 dhe 16
11 shtator? Po ju pyes ta konfirmoni se kjo gjë nuk ishte me
12 përparësi të madhe për njësinë e mbrojtjes dhe të trajtimit të
13 dëshmitarëve?

14 Pë. Ishte për zyrën, por jo për ne si ekip.

15 Py. E kuptoj. Faleminderit për sqarimin. Mbase s'na ndihmoni
16 dot, por çfarë njohuri keni ju që ju bën që të pohoni se ishte
17 me përparësi të madhe për zyrën, kur e pranoni se për ekipin e
18 sigurisë së dëshmitarëve nuk ishte e tillë?

19 Pë. Ekipi i sigurisë së dëshmitarëve vazhdon punën e vet të
20 përditshme, të zakonshme, ndërsa zyra e Prokurorisë fokusohet
21 tek dokumentet, tek botimi i tyre në media.

22 Py. Atëherë kërkoj që të më jepni disa shembuj që ju dini, që
23 ju bëjnë të nxirrni këtë përfundim.

24 Pra është bërë një takim në zyrën e ZPS-së për shembull
25 mbas konferencës e 7 shtatorit?

1 Pë. Mund të jeni më konkret?

2 Py. Po përpiqem. ZPS-ja apo Prokurori apo Zëvendësprokurori,
3 a thirri në takim të gjithë pjesëtarët e zyrës së ZPS-së për
4 të diskutuar konferencën e shtypit të 7 shtatorit? "Po" apo
5 "Jo"?

6 Pë. Nuk kam dijeni për këtë.

7 Py. A u mbledh në një mbledhje e gjithë zyrës nga Prokurori
8 apo Zëvendësprokurori mbas konferencën së 16 shtatorit për të
9 diskutuar se ç'kish ndodhur në 7 dhe 16 shtator, po apo jo?

10 Pë. Në këtë kohë nuk isha në zyrë kështu që nuk mund t'i
11 përgjigjem.

12 Py. Atëherë, nga ato që dini çfarë ju bën të pohoni se ishte
13 me përparësi të madhe për zyrën kur ju thatë që nuk ishte
14 ndonjë përparësi e tillë për zyrën e sigurisë dhe trajtimit të
15 dëshmitarëve?

16 Pë. Në atë kohë isha punonjës i sigurisë dhe merrja urdhra
17 nga shefi.

18 Py. Pra a mos doni të thoni se nuk e dini sesa përparësore
19 ishte për ekipet e tjera të ZPS-së apo për ekipin e sigurisë
20 dhe të trajtimit, konferencat e 7 dhe 16 shtatorit nuk
21 përbënin përparësi të madhe?

22 Pë. Nuk e di. Nuk i përgjigjem dot.

23 Py. Pra ju mund të përgjigjeni vetëm në lidhje me përvojën
24 tuaj të punës në ekipin e sigurisë dhe të trajtimit, kështu?

25 Pë. Po.

1 Py. Atëherë po përqendrohemi aty. Pra për ju si ekip, 7 dhe
2 16 shtatori nuk ishin me përparësi të madhe siç thatë; kështu?

3 Pë. Po.

4 Py. Në dëshminë tuaj, thatë gjithashtu se u diskutua shumë
5 për ato notat. Besoj se e kishit fjalën për notat e
6 dëshmitarëve. Por këto nuk u bënë përpara, më falni pas
7 shtatorit 2020?

8 Pë. A mund ta përsërisni dhe njëherë pyetjen?

9 Py. Po përpiqem të jem më konkret. Ju thatë se nga 24
10 shtatori u hartua një plan nga ZPS-ja për të kontaktuar
11 personat e përmendur me emër, kështu?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë se
13 thatë me kokë por duhet ta thotë me fjalë.

14 DËSHMITARI: Po.

15 Z. REES: [Përkthim]

16 Py. Po ju pyes për periudhën para planit të 24 shtatorit, z.
17 Jukiç, dakord?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Flisni me zë
19 më të lartë që t'ju dëgjojmë.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord.

21 Z. REES: [Përkthim]

22 Py. Dua të na sqaroni një përgjigje që dhatë javën që shkoi
23 që ishte e përgjithshme por nuk e di nëse duhet të jetë pak më
24 konkrete dhe dua që të na ndihmoni. Ju thatë në përgjigjen
25 tuaj se pati shumë diskutime lidhur me shënimet për kontaktet

1 e dëshmitarëve.

2 Pë. Po.

3 Py. Unë do të pyes, të konfirmoni këtu apo të mos pranoni,
4 mos të konfirmoni sugjerimin që po ju bëj, se kur thatë që
5 keni pasur shumë diskutime për këto shënime apo notat e
6 dëshmitarëve, kjo duhet të ketë pasur me hartimin e planit të
7 24 shtatorit, në atë kohë ose pas? Pranoni?

8 Pë. Po.

9 Py. Pra nuk kishte shumë diskutime për këto shënime përpara
10 këtyre konferencave të shtypit të 7 apo të 16-s, qoftë;
11 pranoni?

12 Pë. Po, e pranoj.

13 Py. Dhe siç thatë ju nuk u ndërmor asnjë veprim konkret
14 lidhur me këto ngjarje nga ekipi juaj?

15 Por thatë se zakonisht ekipi i sigurisë së dëshmitarëve
16 bënte takime me telefon me njëri tjetrin.

17 Pë. Po, atëherë kështu ndodhte e vërtetë.

18 Py. Ka ndryshuar kjo praktikë tani?

19 Pë. Në atë kohë nuk ishim në zyrë prandaj.

20 Py. E kuptoj. Pra praktika ka ndryshuar në kuptimin që tani
21 keni tani keni takime fizike. Këtë po thoni?

22 Pë. Dhe përpara kështu ka ndodhur. Përpara lockdown-it.

23 Py. Pra përpara COVID-it. Takimet ishin më fizike. Kishte më
24 shumë takime fizike se gjatë COVID-it kur kishte kufizime dhe
25 më pak mundësi dhe ju ndërkohë vazhduat kontaktet me telefon

- 1 apo me Zoom, nuk e di. Keni përdorur Zoom?
- 2 Pë. Kemi përdorur Teams.
- 3 Py. Kur kufizimet u lehtësuan u kthyet prapë në takimet
- 4 fizike më shumë?
- 5 Pë. Po.
- 6 Py. Pavarësisht nga formati, nga përvoja juaj, kjo ka qenë
- 7 pjesë e punës suaj si ekipi i sigurisë së dëshmitarëve për të
- 8 patur takime të rregullta, të zakonshme ose me telefon ose me
- 9 Teams apo ballë për ballë?
- 10 Pë. Po.
- 11 Py. Këto takime pavarësisht n.q.s. ishin ballë për ballë,
- 12 përmes telefonit, ose përmes Teams-it, mbani ndonjë
- 13 procesverbal lidhur me to apo jo?
- 14 Pë. Jo, nuk mbaj procesverbal për to.
- 15 Py. D.m.th. ishin thjesht diskutime joformale pa ndonjë
- 16 gjurmë pas tyre apo jo?
- 17 Pë. Po, kështu është.
- 18 Py. Po Zëvendësprokurori i Specializuar, a ishte pjesë e
- 19 këtyre takimeve?
- 20 Pë. Jo, nuk ishte.
- 21 Py. Po Prokurori i Specializuar?
- 22 Pë. Jo.
- 23 Py. Po Prokurorët dhe Prokurorët e Asociuar të tjerë, a ishin
- 24 pjesë e takimeve në mënyrë të vazhdueshme?
- 25 Pë. Jo.

1 Py. Takimet ndërmjet ekipit të sigurisë dhe
2 Zëvendësprokurorit të Specializuar, pra në këto takime nuk
3 ishte i përfshirë i gjithë ekipi i sigurisë së dëshmitarëve
4 apo jo?

5 Pë. Po e drejtë është kjo.

6 Py. Pra në këto takime, ishte thjesht Zëvendësprokurori i
7 Specializuar dhe drejtuesi i ekipit të sigurisë dhe trajtimit
8 të dëshmitarëve apo kishte dhe persona të tjerë të pranishëm?

9 Pë. Kishte dhe persona të tjerë.

10 Py. Kush ishin këta persona të tjerë?

11 Pë. Shefi i Hetimeve, Shefi i Njësisë Operative dhe Sigurisë
12 së Dëshmitarit dhe Prokurori i Specializuar.

13 Py. Këto takime organizoheshin në mënyrë të vazhdueshme në
14 mënyrë të tillë që shefat e skuadrave të ndryshme mund t'i
15 jepnin informacion njëri tjetrit?

16 Pë. Këto takime organizoheshin një herë në javë.

17 Py. Pra, këto ishin takime rutinë, të zakonshme dhe ndodhnin
18 pavarësisht se cilat ishin rrethanat apo jo?

19 Pë. Po, kështu është.

20 Py. Po për këto takime a mbaheshin procesverbale?

21 Pë. Jo.

22 Py. Në rregull, d.m.th. këto takime janë bërë në bazë
23 joformale, apo jo?

24 Pë. Po këto ishin takime joformale, ishin takime për shembull
25 operative.

1 Py. Tani t'i kthehemi 22 shtatorit dhe ditëve menjëherë mbas
2 22 shtatorit. Ju thatë që: "Ne identifikuar të gjithë emrat, e
3 kaluar listën, e pamë listën dhe vendosëm që t'i merrnim ata
4 në telefon, dhe t'i informonim për rrjedhjen e
5 dokumentacionit", a është kështu?

6 Pë. Po, kështu është.

7 Py. A mund të ma sqaroni pak më tej, mund të më jepni pak më
8 shumë hollësi lidhur me këtë përgjigje?

9 Kur thoni që identifikuar emrat në listë, ju jeni
10 përqendruar tek dokumentet që znj. Pumper i identifikon si
11 dokumentet e Paketës 3?

12 Pë. Unë nuk jam në dijeni se kush janë dokumentet që janë
13 pjesë e Paketës 3.

14 Py. E kuptoj. E kuptoj, nuk jeni në dijeni se çfarë
15 dokumentesh përfshihen në Paketën 3. Megjithatë, më lejoni tua
16 them ndryshe. Znj. Pumper na përshkroi dokumente të cilat i
17 identifikoi si dokumente të brendshme pune, a të thotë gjë ky
18 term?

19 Pë. Po, më thotë.

20 Py. Kur thoni që kaloni listën të identifikohen emrat, e keni
21 fjalën që identifikuar në këtë produkt të brendshëm pune?

22 Pë. Po e saktë është kjo.

23 Py. Kur thua "ne identifikuar emrat", a mund të na sqarosh
24 pak më tepër se kush ishit ju? D.m.th. kur thua "ne" për kë e
25 ke fjalën? Kush e bëri këtë punë?

1 Pë. "Ne" e kam fjalën për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

2 Py. A t'u dha ty një kopje të produktit të brendshëm të punës
3 dhe a e ke parë, a e ke kaluar vetë dokumentin?

4 Pë. Jo, nuk e kam kaluar vetë.

5 Py. Po ndonjë tjetër në ekipin e sigurisë dhe trajtimit të
6 dëshmitarëve e ka bërë këtë ushtrim?

7 Pë. Po.

8 Py. Kush ishte ky person?

9 Pë. Ishte drejtuesi i ekipit të sigurisë dhe trajtimit të
10 dëshmitarëve.

11 Py. Pra bëhet fjalë për [REDAKTUAR] që e përmendët pak më
12 përpara?

13 Pë. Po e saktë është kjo.

14 Py. Përsëri n.q.s. keni njohuri për këtë ju lutem na ndihmoni
15 dhe n.q.s. nuk keni njohuri ju lutem na e thoni sërish këtë
16 gjë.

17 A e dini ju nëse [REDAKTUAR] e ka marrë kopjen e vet të
18 produktit të brendshëm të punës dhe nga e ka marrë këtë kopje
19 ose këtë produkt?

20 Pë. Nuk e di, nuk kam dijeni për këtë.

21 Py. Kush ia ka dhënë këtë kopje të produktit të punës së
22 brendshëm?

23 Pë. Nuk e di.

24 Py. Kur e ka marrë këtë dokument ai?

25 Pë. Nuk kam dijeni.

1 Py. Por nëse plani është zbatimi nga 22 shtatori e në vijim -
2 a do të ishte e drejtë që të kuptohej për shembull ose të
3 deduktohej që [REDAKTUAR] i kishte marrë informacionet përpara
4 datës 24 shtatorit apo mendonit që një hamendësim që nuk mund
5 ta bëni?

6 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ky është një
7 hamendësim që nuk duhet ta bëjë dëshmitari.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
9 përgjigjuni pyetjes.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju lutem avokat, a mund ta
11 përsërisni dhe njëherë pyetjen?

12 Z. REES: [Përkthim]

13 Py. Po. Operacioni për të thirrur që ishin identifikuar nga
14 lista e produktit të brendshëm të punës të ZPS-së ka filluar
15 më datë 24. A është një përfundim i drejtë për të nxjerrë nëse
16 them se që [REDAKTUAR] e ka marrë një dokument dhe i është
17 kërkuar që të identifikojë listën, emrat në këtë listë
18 dokumentesh përpara datës 24 shtator apo nuk mendoni që ky
19 është një përfundim i drejtë?

20 Py. Mund të jetë dhe data 24.

21 Pë. Po.

22 Py. Po ti vetë nuk e ke parë asnjëherë atë dokument?

23 Pë. Jo, unë nuk e kam parë asnjëherë vetë.

24 Py. D.m.th. ti nuk e di se çfarë dokumenti apo çfarë
25 informacioni i është dhënë [REDAKTUAR] dhe nuk i është dhënë ky

1 informacion [REDAKTUAR]?

2 Pë. Jo, nuk e di n.q.s. i është dhënë apo jo [REDAKTUAR].

3 Py. Por nga ky dokument, [REDAKTUAR] ka hartuar një listë dhe
4 ekipi filloi që të kontaktonte, që të merrte në telefon
5 personat e listës?

6 Pë. Po, e saktë është kjo.

7 Py. Përsëri të lutem na thuaj n.q.s. kjo shkon përtej asaj
8 çfarë dini ju, pra n.q.s. nuk e dini, por pyetja është kjo:

9 A jeni në dijeni ju që nuk ka dokumente të tjera identike
10 me dokumente të cilat janë marrë nga OVL-UÇK-së që etiketohen
11 si produkte të brendshme të punës, gjenden ne sisteme të
12 brendshme formale të ZPS-së. A e dini, jeni në dijeni të kësaj
13 gjëje apo jo?

14 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari tha
15 që nuk është në dijeni të kësaj, nuk ka ndonjë bazë dhe nuk
16 është pyetje e duhur për t'ju bërë dëshmitarit kjo.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet
18 poshtë. Ju lutem përgjigjuni pyetjes.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk kam dijeni lidhur me këtë.

20 Z. REES: [Përkthim]

21 Py. Pra nuk dini n.q.s. është e vërtetë as njëra as tjetra.

22 Kam një pyetje tjetër që rrjedh nga pyetja që sapo ju
23 bëra. Ju lutem na thoni n.q.s. s'keni informacion njësoj na
24 thoni ose përgjigjuni pyetjes.

25 A je ti në dijeni që korrespondenca më e afërt me

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 42

1 dokumentet që janë marrë nga OVL e UÇK-së janë zbuluar më
2 përpara nga vetë Zëvendësprokurori i Specializuar, a ke ndonjë
3 njohuri lidhur me këtë?

4 Pë. Nuk kam njohuri lidhur me këtë.

5 Py. D.m.th. ti nuk na ndihmon dot se ku mund të ruhej
6 informacioni n.q.s. gjendej në një kompjuter ose në një USB?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sapo na tha
8 dëshmitari që nuk e di.

9 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës ju kërkoj ndjesë
10 por edhe një pikë tjetër, po bëhen pohime të cilat mbështeten
11 në gjërat të cilat nuk janë thënë. Pra n.q.s. do të bëjmë
12 pohime, dhe n.q.s. do t'ia shpalosim këto pohime dëshmitarëve
13 ato pohime duhet të jenë të sakta.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
15 Vazhdoni z. Rees.

16 Z. REES: [Përkthim] Mirë. Trupi Gjykues në fakt i ka
17 dëgjuar provat.

18 Py. Pra nuk keni informacion. Faleminderit që na e bëre këtë
19 të qartë.

20 Py. Më lejoni të kaloj te koncepti i dëshmitarit bashkëpunues
21 siç e thatë juve. Pra siç e mbaj mend unë dhe më korrigjoni
22 n.q.s. nuk e kam të qartë këtë. Por ju thatë që emrat të cilët
23 janë identifikuar nga [REDAKTUAR], mbështetur në
24 dokumentet që i ishin dhënë atij, pra u bë vendimi, u mor
25 vendimi që të merreshin në telefon, për sa i takon

1 dëshmitarëve bashkëpunues dhe për t'i informuar ata për
2 rrjedhjen e informacionit. Dëshmitari bashkëpunues si koncept,
3 a përfshin çdo person që është marrë në pyetje nga ZPS-ja, pra
4 është thirrur nga ZPS-ja si dëshmitar dhe ka dhënë deklaratën
5 për ZPS-në. Ky është përkufizimi i dëshmitarit bashkëpunues?

6 Pë. Po, e saktë është kjo.

7 Py. Brenda listës së prodhuar nga [REDAKTUAR] apo jo?

8 Pë. Po, e saktë është dhe kjo.

9 Py. A përfshin ai, persona që janë thirrur nga ZPS-ja si
10 dëshmitarë, po që nuk kanë dhënë dëshmi për ZPS-në?

11 Pë. Përkufizimi nuk i përfshin këta persona.

12 Py. D.m.th. këta persona nuk janë kontaktuar apo jo?

13 Pë. Jo, nuk janë kontaktuar.

14 Py. A përfshihet në këtë koncept një person i cili është
15 intervistuar si dëshmitar, pra është thirrur nga ZPS-ja si
16 dëshmitar, ka dhënë një intervistë, por intervista është që
17 nuk di gjë fare, nuk kam asnjë lloj informacioni për ta
18 ndihmuar ZPS-në për këtë çështje. Po në këtë rast a kemi të
19 bëjmë me një dëshmitar bashkëpunues sipas përkufizimit tuaj
20 dhe a është kontaktuar një person i tillë apo jo?

21 Pë. Po, e saktë është kjo.

22 Py. Po, personat të cilët janë thirrur jo si dëshmitarë, por
23 si të dyshuar dhe që kanë dhënë dëshmi për ju. Këta persona a
24 janë kontaktuar n.q.s. emrat e tyre ishin në listën e
25 dokumentit që është prodhuar nga [REDAKTUAR]?

1 Pë. Jo, nuk i kemi kontaktuar këta persona.

2 Py. Në përvojën tuaj si oficer i sigurisë së dëshmitarëve,
3 besoj se ju jeni në dijeni të faktit që ka një periudhë kohe
4 kur, në mënyrë të debatueshme, ZPS-ja i ka dërguar
5 fletëthirrje personave për t'i thirrur ata për t'i
6 intervistuar si persona të dyshuar. A jeni në dijeni të kësaj?

7 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk është
8 ndërhyrje e saktë kjo. Ose duhet të bëhet një pyetje ose
9 koment nuk mund të bëhen dot të dyja.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
11 bëjeni në trajtë pyetjeje, jo komenti.

12 Z. REES: [Përkthim] Po.

13 Py. A jeni në dijeni të faktit që për një periudhë kohe ZPS-
14 ja i dërgonte fletëthirrje personave për t'i intervistuar ata
15 si persona të dyshuar; a jeni në dijeni të kësaj gjëje?

16 Pë. E përmenda edhe më përpara, nuk jam i përfshirë në hetime
17 dhe nuk e kam fare dijeninë se kush është thirrur si dëshmitar
18 dhe kush është thirrur si i dyshuar.

19 Py. Mirë në rregull, le t'i lëmë mënjane identitetin e
20 personave për momentin. A mund të na konfirmoni ju lutem
21 n.q.s. jeni në dijeni që për një periudhë kohe, për një
22 periudhë të konsiderueshme kohe, ZPS-ja i çonte fletëthirrje
23 individëve për t'i intervistuar ata në statusin e tyre si
24 dëshmitarë të dyshuar?

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari nuk

1 iu referua identitetit të vet, pra është një pyetje e cila
2 është e përgjithshme, është një pyetje e cila u bë dhe më
3 përpara.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. I
5 bëtë një pyetje që i keni bërë dhe më përpara.

6 Z. REES: [Përkthim] Baza pse po i bëj këtë pyetje është
7 që në marrjen në pyetje nga Prokuroria e dëshmitarit si pjesë
8 e ushtrimit për identifikimin se kush ishte kontaktuar ai
9 përmendi si kriter cilësues çdo dëshmitar që ka marrë
10 fletëthirrje nga ZPS-ja dhe ka dhënë një deklaratë. Dhe ai po
11 përdorte procesin e fletëthirrjes për të shpjeguar objektin e
12 ushtrimit të identifikimit të personave të kontaktuar.

13 Kështu që dua që ta çoj pak më tej, pra dua që të
14 eksploroj dhe ta pyes që të na sqarojë pak më tej, të di se
15 çfarë kuptimi kishte ai të personave të thirrur dhe sa i takon
16 identifikimit të listave për të kontaktuar këtë person.

17 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, komenti nuk
18 është i drejtë për dëshmitarin. Përgjigjen e mori avokati dhe
19 n.q.s. përgjigjja e dëshmitarit nuk i pëlqen, kjo është tjetër
20 gjë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta pranoj
22 kundërshtimin. Mund t'i përgjigjeni, mund ta shkurtoni, por
23 n.q.s. nuk e di përgjigjen, nuk e di përgjigjen.

24 Z. REES: [Përkthim] Unë disa herë e kam theksuar në fakt
25 deri tani që n.q.s. nuk e di përgjigjen e pyetjes time ai të

1 thotë që nuk e di përgjigjen. Pra unë do mundohem ta shkurtoj
2 sa më shumë të jetë e mundur por nuk jam i sigurt që ai i ka
3 dhënë përgjigjes time. Pyetja është kjo:

4 Py. Z. Jukiç, a je ti në dijeni të faktit që ZPS-ja ka
5 thirrur individë për të dhënë intervista mbi bazën që ata
6 ishin dëshmitarë të dyshuar.

7 Pë. Po, jam në dijeni.

8 Py. Faleminderit. Kur shpjegoni që personat e kontaktuar
9 ishin persona të cilët kishin marrë fletëthirrje nga ZPS-ja, a
10 bëhet fjalë këtu për persona të cilët ishin thirrur si
11 dëshmitarë të dyshuar?

12 Pë. A e përsërit dot dhe njëherë tjetër pyetjen ju lutem?

13 Py. Po, patjetër. Ti na ndihmove duke na thënë që personat që
14 janë kontaktuar përfshinin personat të cilët ishin përmendur
15 në listën e [REDAKTUAR], që ishin thirrur dhe që kishin dhënë
16 deklaratë për ZPS-në. Na shpjeguat që këtu përfshiheshin
17 persona të cilët janë thirrur si dëshmitarë, por nuk
18 përfshinin persona të cilët ishin të thirrur si të dyshuar.

19 Pra këta persona ti i përjashtove nga ky ushtrim. Tani pyetja
20 që po të bëj unë është kjo: A keni përfshirë apo a keni
21 përjashtuar persona të cilët janë thirrur si dëshmitarë të
22 dyshuar?

23 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, termi
24 "dëshmitarë të dyshuar", është një term me të cilin ne nuk
25 është se njihemi nga ZPS-ja kështu që ju lutem a mund të na i

1 shpjegoni pak se çfarë doni të thoni me këtë përkufizim?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
3 vijoni.

4 Z. REES: [Përkthim] Në fakt z. Jukiç tha që ai është në
5 dijeni të faktit që ZPS-ja ka dhënë fletëthirrje për persona
6 që identifikohen si dëshmitarë të dyshuar.

7 Pra kjo është një sfidë interesante që po më vini përpara
8 të nderuar Gjykatës. Pra ka pasur disa fletëthirrje që i janë
9 dërguar personave për t'i ftuar ata për të dhënë intervistë si
10 dëshmitarë të dyshuar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai e di këtë
12 gjë.

13 Z. REES: [Përkthim] Po mirë z. Pace po thotë tjetër gjë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë bëni
15 pyetjen e radhës.

16 Z. REES: [Përkthim] Tani e lëmë mënjane ndërhyrjen e z.
17 Pace dhe ju lutem përpiquni që t'i përgjigjeni pyetjes që sapo
18 ju bëra. Pyetja ishte kjo:

19 A keni përfshirë apo a keni përjashtuar në listën e
20 kontakteve tuaja individë të cilët janë thirrur për
21 intervistim në cilësinë e dëshmitarëve të dyshuar?

22 Pë. Ne i kemi përfshirë ata n.q.s. ata kanë dhënë deklaratë.

23 Py. Në rregull. Faleminderit. Ju thatë se ky ushtrim, pra

24 plani i 24 shtatorit n.q.s. mund ta quaj kështu është

25 realizuar kryesisht përmes telefonit apo jo?

1 Pë. Po, kështu është.

2 Py. Ti na the javën që shkoi gjatë dëshmisë se numrat e
3 telefonave të dëshmitarëve i keni marrë nga burime publike në
4 Kosovë dhe nga të dhënat që kishit ju.

5 Pë. Po, e saktë është kjo.

6 Py. Cilat janë burimet publike në Kosovë që keni përdorur për
7 të marrë numrat e telefonave?

8 Pë. Internetin edhe të dhënat e valës.

9 Py. Na ndihmoni pak me internetin ju lutem. Cilat janë
10 burimet publike në internet që keni përdorur në mënyrë që të
11 merrni numrat e telefonave të personave që sipas jush ishin
12 thirrur nga ZPS-ja ose si dëshmitarë ose si dëshmitarë të
13 dyshuar dhe kishin dhënë një dëshmi për juve?

14 Pë. Përpara sesa ne i kemi thirrur ne i kemi kontrolluar në
15 internet n.q.s. kishte numër telefoni për ta.

16 Py. Po nuk po flasim për thirrjen e dëshmitarëve këtu. Po
17 flasim për planin e 24 shtatorit dhe ju po thoni, në fakt
18 thatë javën që shkoi që numrat e telefonave të personave që do
19 të merreshin në telefon, i keni marrë nga burime publike në
20 Kosovë dhe nga të dhënat që posedoni ju. Të lutem a mund të na
21 ndihmoni se cilat janë burime publike që keni përdorur për të
22 përfituar për të marrë numrat e telefonave në mënyrë që të
23 realizoni planet e 24 shtatorit

24 Z. PACE: [Përkthim] U bërë kjo pyetje dhe mori përgjigje
25 të nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
2 përgjigjuni pyetjeve.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Mund t'ju ndihmoj. Mbase nuk isha
4 shumë i qartë në atë çfarë thashë, por unë e kisha fjalën për
5 mbledhjen e numrave të telefonave përpara intervistave ose
6 gjatë ose pas intervistave, se numrat e telefonave ne i kishim
7 d.m.th. që në momentin që kishim marrë në intervista këta
8 persona.

9 Py. Pyetja dhe përgjigjja që dhatë javën që shkoi ishte
10 specifike, ishte konkrete dhe lidhej me planin e 24 shtatorit
11 apo jo? Kemi transkriptin në faqen 1695, specifikisht në
12 rreshtin 12 dhe më poshtë.

13 Z. REES: [Përkthim] Nuk e di n.q.s. mund ta shfaqim në
14 ekran në mënyrë që të mund ta shikoni, z. Jukiç.

15 Sa për të dhënë pak më tepër informacion plotësues.

16 Znj. Sekretare nuk e di n.q.s. mund të shohim pak
17 transkriptin, faqe 1694, në rreshtin 4 të kësaj faqe, ti i
18 referohesh 22 dhjetorit edhe në fakt të shkau goja sepse e
19 kishe fjalën për 22 shtatorin apo jo? Për procesverbal e
20 pohoni këtë apo jo?

21 Pra vazhdoni me 22 shtatorin në vijim dhe pastaj në këtë
22 faqe, në faqen 1695, juve përshkruani sesi është hartuar lista
23 e personave që do të kontaktoheshin dhe cilat ishin kriteret e
24 ndjekura për këtë gjë. Në rreshtin 12, z. Pace ju pyet lidhur
25 me kontaktet telefonike të këtyre personave: "A mund të na

1 shpjegoni ju lutem sesi i morët numrat e telefonave të këtyre
2 personave”?

3 Përgjigjja është që:

4 “Ne i morëm këta numra telefonash nga burimet publike në
5 Kosovë dhe nga dëshmitarët gjatë intervistimit të tyre sepse
6 ata na kanë dhënë në këto intervista numrat e tyre të
7 telefonave”.

8 Ndalojmë këtu. A po flisnim këtu për numrat e telefonave
9 për kontaktimin e dëshmitarëve si pjesë e planit e 24
10 shtatorit apo jo?

11 Pë. Siç jam përgjigjur dhe më parë, neve i kemi siguruar
12 numrat e telefonave përpara intervistave dhe gjatë
13 intervistave drejtpërsëdrejti nga dëshmitarët. Ne kemi bazën
14 tonë të të dhënave me numrat e telefonit dhe kështu kemi
15 filluar që të telefonojmë më 22 shtator.

16 Py. Por kjo bazë e të dhënave nuk përcaktohet si burimi për
17 numrat e telefonave. Pra a do të thotë që telefonat janë marrë
18 dhe nga burimet publike?

19 Pë. Nuk janë të shkruara në bazën e të dhënave, por në
20 përgjithësi janë të shkruara në Notën Zyrtare numrat e
21 telefonave. Në notat e intervistave aty i kemi numrat e
22 telefonave të personave të intervistuar.

23 Py. Në përvojën tënde, a të ka ndodhur ndonjëherë që
24 individët të të japin një numër telefoni që më pas juve e
25 kuptoni që nuk punon, nuk funksionon, nuk është i saktë?

1 Pë. Nuk e mbaj mend këtë situatë.

2 Py. Në përvojën tënde, a ke parë persona që ju kanë dhënë
3 numra telefonash që funksionojnë, që bie zilja por askush nuk
4 i përgjigjet telefonit në momentin kur e merr në telefon.

5 Pë. Po.

6 Py. Në përvojën tënde, a ka individë që humbin interes për të
7 bashkëpunuar me hetuesit?

8 Pë. Po, e saktë është.

9 Py. A ka të tjerë sipas përvojës tuaj që mbase kanë motive të
10 tjera për të mos vijuar që të kenë kontakte me ZPS-në?

11 Pë. Po, e saktë është edhe kjo.

12 Py. Dhe mbase ne të gjithë mund të mendojmë për arsyet e
13 mundshme sepse. Nuk më duhet që t'i shtjelloj me ty këto arsye
14 z. Jukiç, megjithatë, le të përpiqemi që të përqendrohemi te
15 disa prej motiveve.

16 Një motiv i dukshëm është që për shembull një individ ka
17 dhënë një dëshmi që ata për shembull e dinë që nuk do të
18 kalojë apo nuk mund ta përballojë le të themi analizën që do
19 të bëhet në Gjykatë apo në sallën e gjyqit.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është
21 hipotetike dhe jorelevante. Nuk jam i sigurt n.q.s. dëshmitari
22 mund të ndihmojë procedurat dhe sesi ai mund të ndihmojë sa i
23 takon kësaj linje pyetjesh.

24 Z. REES: [Përkthim] Mirë. Atëherë mendoj që motivimet
25 janë të dukshme për një individ që mund të humbë interesin.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 52

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Rees.

2 Vetëm një moment.

3 Për momentin mikrofoni ishte i fikur, megjithatë

4 kundërshtimi pranohet.

5 Ka ardhur koha për pushimin e kafes.

6 Znj. Sekretare, ju lutem nxirreni dëshmitarin nga salla e

7 gjyqit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbyllim

10 këtu këtë seancë. Do të mblidhemi sërish në orën 11.30.

11 ---Pauza fillon në orën 10.59.

12 ---Seanca rifillon në orën 11.30

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja

14 ndihmëse, mund ta sillni dëshmitarin.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të

17 uleni z. Jukiç.

18 Dhe ju z. Rees, mund të vazhdoni.

19 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

20 Py. Në rregull, z. Jukiç?

21 Pë. Po.

22 Py. Pak përpara pushimit, folëm për përvojën tuaj

23 profesionale dhe ju thatë që kishit hasur në individë që

24 kishin dhënë numra telefoni për kontakte dhe dëshmitarë dhe

25 individë që nuk ishin përgjigjur në telefon; kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Dhe, në rrethanat që ndodhën, ju u përpoqët të gjeni
3 mënyra të tjera për t'i kontaktuar këta individë?

4 Pë. Po.

5 Py. Për shembull, në qoftë se një numër i telefonit që një
6 person e ka dhënë gjatë intervistës nuk ka qenë i mjaftueshëm
7 për të mbetur në kontakt me atë person, ju keni mund edhe të
8 kontrolloni burimet publike për të parë në qoftë se ka ndonjë
9 numër alternativë për kontaktimin e atij individi?

10 Pë. Po, kështu është.

11 Py. Dhe ju thatë që numrat e telefonit i merrni si nga vetë
12 dokumentacioni i ZPS-së ashtu edhe nga burime publike.

13 Pë. Thashë që zakonisht përpigësim të merrnim numra telefon
14 nga burimet publike para thirrjes së personave për intervistë.

15 Py. Po. Po unë po ju pyes në qoftë se gjatë asaj që bëtë më
16 24 shtator, a u bënë përpjekje për t'i kontaktuar dëshmitarët
17 me numrat që jua kishin dhënë paraprakisht dhe, në qoftë se
18 po, nëse kjo ishte e suksesshme apo kërkuat burime publike për
19 të gjetur të dhënat e tyre të kontaktit?

20 Pë. Nuk kërkuam nga burime publike të dhëna të tilla.

21 Py. Gjatë përvojës tuaj profesionale, a keni hasur në
22 individë që kanë kërkuar ndihmë financiare nga hetues?

23 Pë. Ka njerëz që kërkojnë apo që kanë kërkuar ndihmë
24 financiare.

25 Py. Gjatë përvojës tuaj profesionale, a keni hasur në

1 individë që p.sh., kërkojnë shpërnguljen apo zhvendosjen në
2 mënyrë që të përmirësojnë mënyrën e jetesës dhe strehimin?
3 Pë. Kjo nuk është e saktë.

4 Py. Po a keni hasur në individë që kanë kërkuar
5 shpërngulje dhe ju e keni shqyrtuar kredibilitetin e tyre në
6 qoftë se, pra, e kanë bërë këtë kërkesë si mënyrë për
7 përmirësimin e jetës së tyre?

8 Pë. Kjo nuk është e saktë.

9 Py. Gjatë përvojës tuaj, shpërngulja apo zhvendosja a është e
10 mundur si mjet për të siguruar që hetuesit të dinë
11 vendndodhjen e një individi për të cilin nuk duan, domethënë,
12 të cilin nuk duan ta humbin, të cilin duan ta dinë gjithë
13 kohës se ku mund të ndodhet?

14 Pë. Jo, kjo nuk është e saktë.

15 Py. Ju thatë që personalisht keni marrë pjesë në bërjen e 30
16 telefonatave dhe se jeni takuar ndoshta me dhjetë persona në
17 lidhje me ngjarjet e shtatorit 2020. A ju kujtohet kjo
18 përgjigje?

19 Pë. Po. Më kujtohet.

20 Py. Në nxjerrjen e të dhënave të kontaktit të dëshmitarëve që
21 sipas Prokurorisë lidhen me këtë çështje ju keni bërë 11
22 Shënime Zyrtare të tilla, apo jo?

23 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshmitari nuk
24 është pjesë e ekipit të Prokurorisë apo të nxjerrjes së
25 materialeve. Prandaj duhet të bëhet pyetja brenda dijenisë së

1 vet dëshmitarit.

2 Z. REES: [Përkthim] Atëherë do ta parafrazoj pyetjen.

3 Py. Ju keni kontaktuar 11 - më falni - keni bërë shënime
4 kontakti për 11 dëshmitarë: kështu?

5 Pë. Nuk më kujtohet.

6 Py. Dhe ju paraqiteni si emër vetëm në dy shënime të tjera;
7 apo jo?

8 Pë. Siç thashë, nuk më kujtohet sa shënime të tilla kam bërë.

9 Py. Ka dy shpjegime apo jo? Njëri është se, ju thoni, që bëni
10 shënime për kontaktin -- pas çdo kontakti të bërë se duhet të
11 ketë më shumë shënime kontaktesh në atë rast sepse ju vetë
12 keni marrë pjesë në rreth 30 thirrje telefonike dhe ndoshta
13 jeni takuar me të paktën dhjetë njerëz; ose, shpjegimi i dytë,
14 kemi 11 dëshmitarë dhe shënime kontakti në lidhje me ata
15 sepse, në fakt, numri i telefonatave ku keni marrë pjesë ju,
16 në lidhje me këtë incident, ka qenë shumë më i vogël se ai që
17 na thatë javën e kaluar, a është kështu?

18 Pë. Sa më kujtohet, ka dy Shënime Zyrtare ku përfshihen më
19 shumë dëshmitarë të kontaktuar. Në njërin mendoj që ka 12 apo
20 14 dëshmitarë të kontaktuar.

21 Py. Në rregull. Të shikojmë, pra, shënimet për kontaktet pak
22 më vonë.

23 Tani do t'ju pyes kështu: Kemi 11 dëshmitarë dhe shënime
24 kontakti në lidhje me ta që i keni bërë ju dhe dy Shënime të
25 tjera Zyrtare ku paraqiteni ju, emri juaj?

1 Pë. Mund ta përsëritni pyetjen?

2 Py. A mund të na konfirmoni se numri i saktë i kontakteve me
3 dëshmitarët në lidhje me ngjarjet e shtatorit 2020 reflektohet
4 në shënimet e kontaktit për 11 dëshmitarë?

5 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtoj këtë
6 pyetje, duhet njëherë të vërtetohet relevenca e kësaj
7 pyetjeje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pranohet
9 kundërshtimi.

10 Z. REES: [Përkthim]

11 Py. Ju keni parë 11 -- një Shënim Zyrtar për 11 dëshmitarë që
12 keni bërë ju dhe këtu e keni kaluar bashkë me z. Pace gjatë
13 pyetjeve?

14 Pë. Po.

15 Py. Ju faleminderit. Tani, a mund të konfirmoni në qoftë se
16 dëshmitarët e kontaktuar dhe ato shënime që keni bërë ju,
17 përveç atyre dy që z. Pace ua ka treguar gjatë përgatitjeve,
18 se pasqyrojnë mënyrë të saktë numrin e personave të kontaktuar
19 në lidhje me ngjarjet e shtatorit 2020.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e dimë në
21 qoftë se dëshmitarët kanë një bazë për dijeninë e tyre në
22 lidhje me atë se çfarë është nxjerrë apo jo këtyre
23 dokumenteve.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
25 përgjigjet dëshmitari.

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk mendoj që
2 është një pyetje e drejtë për dëshmitarin.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
4 përgjigjesh dëshmitar.

5 Z. REES: [Përkthim]
6 Py. A e dini se ku janë këto shënime?

7 Pë. Këto janë në sistemin ZyLab.

8 Py. A dini se dhe sa shënime kontakti për dëshmitarët të
9 rëndësishme ka në sistem për të cilat nuk na ke treguar?

10 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të definohet
11 termi "të rëndësishme" apo "relevante" në këtë kontekst?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
13 përgjigjeni.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e di.

15 Z. REES: [Përkthim] Përsëri e përplasa dorën.

16 Py. A është e mundur që 11 shënimet e kontaktit që i bëtë dhe
17 dy ato që jua tregoi z. Pace gjatë pyetjeve të tij të

18 reflektojnë në mënyrë të saktë numrin e kontakteve që keni

19 pasur ju me dëshmitarët në lidhje me ngjarjet e shtatorit 2020

20 apo nëse ju qëllimisht ose pa dashje keni zmadhuar ose keni

21 dhënë një vlerësim më të lartë të numrit të telefonatave dhe

22 takimeve në të cilat keni marrë ju vetë personalisht pjesë.

23 Pra, bëhet fjalë për kontaktimin e këtyre dëshmitarëve dhe

24 këtyre 30 telefonatave që përmendët më herët që i keni pasur

25 dhe takimet me dhjetë njerëzit?

1 Pë. Sikurse thashë më herët, ka pasur rreth 30 telefona dhe
2 unë jam takuar me përafërsisht dhjetë persona.

3 Py. Në rregull. Nuk e dini saktësisht.

4 Ju gjithashtu thatë që keni marrë pjesë në këtë veprim
5 gjatë gjithë kohës, domethënë, keni qenë aktivisht përfshirë
6 në këtë veprim. A mund të na konfirmoni këtë?

7 Pë. A mund të ma përkufizoni "gjatë gjithë kohës"?

8 Py. Unë vetëm po e them atë që thatë ju.

9 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'i
10 lexohet dëshmitarit përgjigjja sikurse ka thënë në transkript?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ta
12 nxjerrim atëherë transkriptin dhe ta lexojmë referencën e
13 saktë për dëshmitarin.

14 Z. REES: [Përkthim] Në rregull. Faqja e transkriptit 101,
15 rreshtat 15 deri në 19.

16 A mund të ndërhyjë dhe t'i bëjë një kërkesë të shkurtër
17 sekretares?

18 [Mbrojtja dhe Sekretarja e Gjykatës
19 këshillohen]

20 Z. REES: [Përkthim]

21 Py. Z. Jukiç, Në krye të kësaj faqe, në rreshtin numër 4, z.
22 Pace ju shpjegon se pyetjet e tij kishin të bëjnë me
23 aktivitetin e shtatorit, pra, me planin e 24 shtatorit; e
24 shikoni këto?

25 Pë. Po.

1 Py. Shikoni rreshtin 13. Aty ju pyet:

2 "Si mund ta përshkruani këtë veprim për sa i përket
3 intensitetit dhe kohës"?

4 Përgjigje:

5 "Unë isha i përfshirë gjatë gjithë kohës në këtë
6 aktivitet".

7 A ju kujtohet tani që e keni thënë kështu?

8 Pë. Po, më kujtohet.

9 Py. Ju gjithashtu thatë, apo jo, se thirrjet telefonike,
10 secila prej tyre ka zgjatur përafërsisht 15 minuta; ju
11 kujtohet?

12 Pë. Po, më kujtohet.

13 Py. Edhe tek vlerësimi më i lartë, të themi, që e bëni ju
14 rreth 30 thirrje të tilla prej rreth 15 minutash secila,
15 flasim për një ditë pune të kaluar në telefonata. A pajtoheni
16 me mua?

17 Pë. Jo, nuk pajtohem.

18 Py. Po 30 telefonata herë 15 minuta, përafërsisht, del kaq?

19 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e di. Në qoftë se Mbrojtja pret
20 nga dëshmitari që të bëjë aritmetikë apo që do të bëjë ndonjë
21 pyetje tjetër.

22 Z. REES: [Përkthim]

23 Py. Një ditë e punës ka tetë apo nëntë orë, apo jo?

24 Pë. 12 orë.

25 Py. 12 orë. Atëherë 30 telefonata nga 15 minuta është më pak

1 se një ditë pune e juaja; a pajtoheni?

2 Pë. Nuk pajtohem.

3 Py. Ju thoni se këto 30 thirrje telefonike, për afërsisht,
4 prej 10 minutash ju morën gjithë kohën. Për cilën periudhë?
5 Për çfarë periudhe e keni fjalën? Sa kohë për afërsisht?

6 Pë. Tre ditë.

7 Py. Në rregull. Ju gjithashtu thatë se u bënë gjithsej
8 afërsisht 200 thirrje telefonike nga të gjithë punonjësit e
9 ZPS-së që ishin të përfshirë në këtë planin e 24 shtatorit.

10 Z. REES: [Përkthim] A mund të shikojmë, ju lutem, faqen e
11 transkriptit 1369, rreshtat 17 e më tutje.

12 Py. A e shikoni aty pyetjen e bërë:

13 "A mund të na thoni për afërsisht se sa thirrje telefonike
14 u bënë nga të gjithë anëtarët e stafit të ZPS-së të marra së
15 bashku si pjesë e këtij plani?"

16 Përgjigje:

17 "Kemi bërë rreth 200 thirrje, telefonata. Dhe i kemi
18 dokumentuar ato në Shënimet Zyrtare".

19 E shikoni këtë?

20 Pë. Po, e saktë.

21 Py. Dua të qartësoj një gjë në këtë rast. Më vonë, në qoftë
22 se e shikoni faqen 1761, rreshtin 16. Nuk po bëj kritikë. Se
23 kështu gjërash mund të ndodhin. Por, a shikoni në rreshtin 16
24 ju rikujtojnë, me kushtin, në qoftë se s'e kam gabim, se në
25 mëngjes kishit thënë se kishit kontaktuar rreth 200

1 dëshmitarë. Mirëpo sikur e pamë tani, ju keni thënë faktikisht
2 se janë bërë 200 thirrje telefonike dhe jo se janë kontaktuar
3 200 dëshmitarë. A është kështu? E shikoni këtë?

4 Pë. Po, e shikoj.

5 Py. Dhe e shoh që jeni pajtuar me pyetjen, jeni përgjigjur:

6 "Po, rreth 200."

7 Por, nga dëshmia juaj del se bëhet fjalë për 200 thirrje
8 telefonike dhe jo 200 dëshmitarë.

9 Dhe ju thatë që ju vetë nuk jeni përfshirë në
10 planifikimin e operacionit të 24 shtatorit por vetëm keni
11 bërë telefonata, a është kështu?

12 Pë. Po, e saktë.

13 Py. Sigurisht që ZPS-ja ju ka ftuar për të dhënë dëshmi në
14 mënyrë që të na ndihmoni rreth pasojave operative në rolin
15 tuaj si jo vetëm oficer i sigurisë së dëshmitarëve deri në
16 janar, por edhe si kryes i detyrës së udhëheqësit të ekipit
17 për sigurinë e dëshmitarëve nga janari 2021 më tutje. Padyshim
18 që ju i keni parë dokumentet, keni parë shënimet; apo jo?

19 Pë. Po.

20 Py. Dhe i keni shqyrtuar ato, i keni rishikuar?

21 Pë. Po.

22 Py. Dhe nuk na keni dhënë një analizë të saktë gjatë dëshmisë
23 së javës së kaluar. Po na keni dhënë një ide të përgjithshme
24 në lidhje me pasojat që për të cilat kanë folur dëshmitarët të
25 cilat janë shënuar në Shënimet Zyrtare; kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Atëherë do t'ju ndihmoj edhe unë do t'i kalojmë së bashku
3 disa Shënime Zyrtare në lidhje me kontaktimin e dëshmitarëve.
4 Mundësisht më thoni se pajtoheni apo nuk pajtoheni apo nuk e
5 dini.

6 Pë. Mos u bëni merak se do të veproj si duhet.

7 Py. Ju faleminderit, z. Jukiç.

8 Py. Na janë dhënë 114 shënime për kontaktimin e dëshmitarëve.
9 Në njërin prej tyre nuk flitet për kontaktimin e dëshmitarit,
10 mirëpo për kontaktimin e personit me emër [REDAKTUAR] më datën
11 8 mars 2021. Duke qenë se janë shënime anonime dhe duke marrë
12 parasysh se ju më herët keni thënë se në disa shënime zyrtare
13 janë shënuar kontakte me më shumë dëshmitarë jo vetëm me një,
14 a është kështu?

15 Pë. Po.

16 Py. Atëherë sipas nesh ka 139 thirrje telefonike apo mesazhe
17 apo takime që janë regjistruar në ato Shënime Zyrtare për
18 kontaktimin e dëshmitarëve. A do të pajtoheshit në këtë rast
19 me mua, se shifra 139 është më konkrete dhe më e saktë për sa
20 i përket numrit të telefonatave, mesazheve apo takimeve me
21 dëshmitarët?

22 Pë. Unë nuk di si t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

23 Pë. Në rregull. Atëherë, duke marrë parasysh se shënimet janë
24 anonime, dy shënime mund të t'i referohen kontaktit me dy
25 dëshmitarë të ndryshëm, apo gjithashtu mund t'i referohen dhe

1 dy kontakteve të ndryshme me një dëshmitar të vetëm. A është
2 kështu? A pajtoheni me mua?

3 Pë. Po.

4 Py. Atëherë, numri maksimal i personave që ZPS-ja mund t'i
5 quajë "dëshmitarë" individë me të cilët ka folur ZPS-ja apo
6 individë nga të cilët ka marrë mesazh apo persona me të cilin
7 është takuar ZPS-ja, pra, kjo shifër maksimale mund të jetë
8 113.

9 Z. PACE: [Përkthim] A është duke dhënë vetë dëshmi
10 avokati apo i kërkon ndonjë përgjigje dëshmitarit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
12 me atë pyetje.

13 Z. REES: [Përkthim] A pajtoheni me mua, dëshmitar, se të
14 dhënat tregojnë se numri maksimal i dëshmitarëve që u
15 kontaktuan është 113?

16 Pë. Nuk e di këtë.

17 Py. Dhe ka pasur dhe katër kontakte të tjera me një person që
18 është identifikuar si "i biri" i dhe është e fshirë. Pra, nuk
19 bëhet fjalë për një kontakt të personit që mund të përshkruhet
20 si dëshmitar por me një person që mund të jetë i biri i atij
21 personi. Ju kujtohet kjo?

22 Pë. Po, më kujtohet.

23 Py. Dhe meqë bëhet fjalë për anonimitet, atëherë, nuk dimë në
24 qoftë se është i njëjti djalë i të njëjtit person apo dy djem
25 të ndryshëm apo të paktën dy djem të të njëjtit person apo një

1 djalë tjetër i një individi tjetër dhe kështu me radhë. A ju
2 kujtohet se kush prej këtyre katër kontakteve me djalin e një
3 personi të pidentifikuar bën fjalë për të njëjtin -- nëse ajo
4 bën fjalë për të njëjtin person apo persona të ndryshëm?

5 Pë. Më kujtohet ai shënim dhe bëhet fjalë për të njëjtin
6 djalë, jo për dy persona të ndryshëm.

7 Py. Tani të shikojmë periudhën kohore të kontakteve. Të
8 fillojmë me periudhën që fillon më 7 shtator, pra, data e
9 konferencës së parë për shtyp dhe deri në periudhën që mbulon
10 edhe 23 shtatorin. Domethënë, një ditë pas konferencës së
11 tretë. Gjatë kësaj periudhe regjistrohen në Shënimet Zyrtare
12 vetëm 13 thirrje telefonike ose takime apo mesazhe me
13 dëshmitarin. A pajtoheni se ky është numri i saktë apo indikim
14 i saktë i atij numri të kontakteve?

15 Pë. Nuk më kujtohet ai informacion.

16 Py. Dhe këto 13 kontakte, jo të gjitha 13 prej një individi
17 të bëra me ZPS-në, mirëpo prej më shumë individësh me të
18 gjithë këta persona ZPS-ja ka folur. A është kështu z. Jukiç?

19 Pë. Nuk mund të jem i saktë, sikurse thashë, unë nuk mora
20 pjesë në të gjitha telefonatat.

21 Py. Tani të shikojmë planin e 24 shtatorit për marrjen e një
22 iniciative nga ZPS-ja për kontaktinim e individëve që kishin
23 paraqitur shqetësimet e tyre. Menjëherë pas 24 shtatorit,
24 domethënë, duke filluar nga 24 shtatori dhe ditët në vijim e
25 deri në fund të shtatorit, shënimet tregojnë për 38 thirrje

1 telefonike ose takime apo mesazhe. Dhe se në dy javët para të
2 tetorit ky aktivitet ka vazhduar me 56 telefonata të tjera,
3 takime apo mesazhe.

4 A pajtoheni se ky është një reflektim i saktë i asaj se
5 çfarë ka ndodhur pas 24 shtatorit?

6 Z. PACE: [Përkthim] Unë statistikën që paraqet Mbrojtja
7 nuk i kam. Dhe kur ai i bën pyetjet dëshmitarit, unë dua ta
8 kem të qartë në qoftë se ato analiza kanë të bëjnë dhe janë të
9 bazuara me analizën që ka bërë Mbrojtja apo me shënimet e
10 nxjerra.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne nuk
12 kemi asgjë në procesverbal lidhur me këtë, z. Rees.

13 Z. REES: [Përkthim] Mendoj që është me vend që
14 dëshmitarit mund t'i bëhet pyetje në qoftë se e pranon apo jo
15 vërtetësinë e atyre shifrave.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë,
17 mund t'i tregoni paraprakisht dëshmitarit se prej nga i keni
18 nxjerrë këto shifra.

19 Z. REES: [Përkthim] ZPS-ja e ka thirrur këtë dëshmitar
20 për të treguar nivelin e aktivitetit që ka ndërmarrë ZPS-ja në
21 vijim të pesë konferencave.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kjo nuk
23 është pyetje diskutimi në këtë moment. Në këtë moment me
24 rëndësi janë pyetjet që i bëni dëshmitarit. Kështu që, ju
25 lutem, të na e tregoni burimin e informacionit që keni.

1 Z. REES: [Përkthim] Në rregull.

2 Py. Z. Jukiç, e kam të qartë se unë nuk mund të jap dëshmi
3 dhe nuk jam duke dhënë dëshmi, mirëpo sikurse ju kam thënë,
4 sipas analizës sonë dhe po e përsëris përsëri, sipas analizës
5 që i kemi bërë ne të dhënave, ju mund të më thoni në qoftë se
6 pajtoheni ose jo ose nuk e dini informacionin që ju paraqes.

7 Pra, unë them, se 13 telefonata apo takime apo mesazhe,
8 gjatë periudhës prej 7 deri më 23 shtator, janë shënuar në
9 këto shënime zyrtare. Më 24 shtator, kur keni filluar edhe ju
10 me ndërhyrjen tuaj, e deri në fund të shtatorit 38 telefonata,
11 takime ose mesazhe. Dhe prej 1 tetorit deri më 14 tetor edhe
12 56 telefonata e kontakte të tjera. A pajtoheni me këto shifra?
13 Mund të thoni po ose jo ose se nuk e dini?

14 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në qoftë se
15 Mbrojtësi mund t'i kufizojë pyetjet e tyre një nga një?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.
17 Pajtohem me ju. Bëni pyetjet një nga një sepse ju kishit më
18 shumë pyetje të përmbledhura në një z. Rees.

19 Z. REES: [Përkthim] Në rregull.

20 Py. Trajtuam periudhën prej 7 deri më 23 shtator. 14 shtator
21 deri më 23 shtator, 38 telefonata, takime apo mesazhe. A
22 pajtoheni me këtë shifër?

23 Pë. Nuk e di.

24 Py. Prej 23 shtatorit e deri më 1 tetor me atë shifër a
25 pajtoheni?

1 Pë. Nuk e di.

2 Py. Po ju a pajtoheni se pas datës 14 tetor ky aktivitet
3 aktivisht ka përfunduar dhe numri i telefonatave ka rënë?

4 Pë. Nuk pajtohem.

5 Py. 14 tetor deri në 31 tetor, 9 telefonata, takime ose
6 mesazhe të shënuara në shënimet e kontaktit të dëshmitarit.

7 Pajtoheni me këtë shifër?

8 Pë. Nuk e di.

9 Py. Nuk e dini? Atëherë ta bëj pyetjen ndryshe: A pajtoheni
10 se aktiviteti u zvogëlua pas datës 14 tetor?

11 Pë. Ky aktivitet u finalizua nga mesi i dhjetorit.

12 Py. Pra, ti nuk e di nëse të dhënat janë të sakta kur thonë,
13 se nga 14 deri në 31 tetor, ka pasur nëntë telefonata takime
14 apo mesazhe.

15 Dhe pastaj në nëntor. Besoj ka pasur telefonata takime.

16 Pajtoheni me mua?

17 Pastaj në dhjetor, ka pasur tetë telefonata, takime apo
18 mesazhe. Pajtoheni, nuk pajtoheni, nuk e dini?

19 Pë. Nuk e di.

20 Py. Siç thatë, kjo sipërmarrje, të themi, përfundoi në
21 dhjetor. Pastaj pati disa kontakte, në fakt, të pakta në mars
22 dhe një në korrik të 2021. Pajtoheni me këtë? Thoni pajtohem,
23 nuk pajtohem, nuk e di?

24 Pë. Nuk e di.

25 Py. Pajtoheni me mua kur them se shënimet e dëshmitarëve nuk

1 thonë asgjëkundi se ka pasur një të bërtitur të një
2 dëshmitari. Ju kujtohet kjo? Atëherë pajtohesh me këtë, se
3 shënimet regjistrojnë, kanë të regjistruar ose shënuar të
4 gjitha shqetësimet në çfarëdo lloj niveli të kenë qenë të
5 shprehur nga një person në 37 shënime? Më thuaj pajtohesh, nuk
6 pajtohesh, nuk e di?

7 Pë. Nuk e di.

8 Py. Në shumicën e madhe të këtyre shënimeve, në fakt, 77 janë
9 regjistruar shprehimisht se nuk ka pasur ndonjë shqetësim nga
10 ky person? Pajtoheni, nuk pajtoheni, nuk e di?

11 Pë. Nuk e di shifrën.

12 Z. REES: [Përkthim] Ne e kemi dëgjuar në fakt provën.
13 Ndoshta në kuadrin e ndërhyrjes së z. Pace për procesverbal,
14 ndoshta mund të ketë një përpjekje, do të ishte mirë që të
15 kishim një diskutim *inter partes*, sa i takon fakteve të rëna
16 dakord lidhur me këtë analizë.

17 Py. Javën që shkoi juve ju bë pyetja sa persona ju thanë juve
18 që kishin marrë kërcënime, domethënë, sa veta ishin kërcënuar
19 pas shtatorit të viti 2020, përgjigja që dhatë juve ishte që
20 "Nuk e mbaj mend".

21 Z. REES: [Përkthim] Ju lutem, a mund të shikojmë
22 transkriptin në faqen 1762 në mënyrë që të kujtoheni për këtë
23 çfarë keni thënë. Nëse do të shohim rreshtin 2, më falni
24 rreshtin 4.

25 Py. Pyetja që të bëhet është kjo:

1 "Sa veta të thanë që janë kërcënuar pas shtatorit 2020?"

2 Përgjigja nga ju ishte që:

3 "Nuk e mbaj mend".

4 Nuk ishte kështu?

5 Pë. Po, e saktë është kjo.

6 Py. A është akoma e saktë kjo gjë?

7 Pë. Unë mbaj mend pjesën më të madhe por nuk i mbaj mend të
8 gjitha.

9 Py. Këtë e thoni sot. Por, në fakt, më datën 28 tetor kur iu
10 bë pyetja që të thoni afërsisht, domethënë, se sa veta mbani
11 mend ju thoni "shumë pak". A e shikoni këtë tek rreshti 8?

12 Pë. Po.

13 Py. Pra, jo pjesa më e madhe. Po thoni "pak". Kështu që nuk
14 është se po bëj ndonjë kritikë këtu, por dua që me fjalët e
15 tua të na shpjegosh se sa nënkuptoni juve kur thoni "shumë
16 pak".

17 Pë. Me aq sa di unë dy.

18 Py. Faleminderit. Mirë atëherë kjo është në përputhje me
19 analizën tonë të paktën pjesërisht. Dhe ne do ta shpjegojmë
20 dhe do ta trajtojmë këtë gjë.

21 Atëherë kemi dy nota kontakti. Njëra i referohet -
22 ndoshta dhe mund të na ndihmosh në qoftë se të kujtohet - pra,
23 njëra i referohet një postimi në Facebook të KosovaPress; apo
24 jo?

25 Pë. Nuk e mbaj mend.

1 Py. Ajo çfarë thuhet aty është që një person që nuk dihet se
2 kush është shpreh një opinion lidhur me ngjarjet e datës 7
3 shtator, domethënë, në konferencën për shtyp dhe çfarë ishin
4 këto ngjarje të cilat janë treguar në deklaratën, në njoftimin
5 për shtyp.

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndoshta do të
7 ishte më me ndihmë që kjo notë mund t'i jepej dëshmitarit për
8 ta ndihmuar dëshmitarin që të mbaj mend më mirë dhe të japë
9 detajet lidhur me pyetjen e bërë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jam
11 dakord. Ndoshta do ta ndihmonte për ta sqaruar më tej çështjen
12 në qoftë se do të specifikonim dokumentin në fjalë.

13 Z. REES: [Përkthim] Mirë në rregull. Është dokumenti me
14 numër identifikimi ERN 089997.

15 Py. A mund të shihni aty që përmendet që ka mesazhe që janë
16 shkëmbyer dhe thuhet më tej që më datën 7 shtator duket sikur
17 dokumenti i parë ka të bëjë me një lidhje në adresën
18 Facebook.com për KosovaPress-in. Nuk e di në qoftë se mund ta
19 shikosh? E shikon atë me ngjyrën blu të dhënë në dokumentin që
20 keni përpara?

21 Ndërkohë që kemi një tjetër mesazh, sërish nga një person
22 identiteti i të cilit nuk dihet, që duket sikur raporton
23 opinionin e vet lidhur me ato çfarë është bërë më 7 shtator.
24 Domethënë, në kuptimin që në çfarë nxjerrje është bërë më 7
25 shtator. Nuk e di në qoftë se mund ta shikoni dhe këtë është

1 nën pikën 17.19?

2 Pë. Po, e shoh dhe këtë.

3 Py. Ky është një ndër dokumentet që i referohet kërcënimi.

4 Ndërkohë që kemi dhe një tjetër dokument. Është dokument i
5 cili lidhet me 18 mars 2021. A jeni dakord? Domethënë, është
6 përmendja e dytë e kërcënimit.

7 Z. PACE: [Përkthim] Sërish, kërkohet që dëshmitari të
8 mbajë mend diçka ndërkohë që mund të ketë një notë që mund ta
9 ndihmojë atë.

10 Z. REES: [Përkthim] Pra, dua që konstatoj njëherë në
11 qoftë se ka dijeni apo jo dhe pastaj mund të jap detaje të
12 tjera.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund ta
14 bëni pyetjen dhe pastaj vijoni më tej.

15 Z. REES: [Përkthim]

16 Py. Atëherë, sa për ta qartësuar. Në rastin e dytë, mos e
17 mbani mendjen tek data 18 mars, por do të doja të thosha në
18 qoftë se e mbani mend apo jo mbas 24 shtatorit, mbas ushtrimit
19 e 24 shtatorit, a e mbani mend atë çfarë përmend ky dokument?

20 Pë. Nuk e mbaj mend.

21 Py. Nuk e mbani mend. Në rregull. Tani le të kalojmë tek një
22 dokument tjetër. Shënimet e kontaktit të dëshmitarit
23 identifikohet me numrin 094748.

24 [Nuk ka përkthim 12:11:16-14:02]

25 I AKUZUARI GUCATI: Nuk e dëgjoj kur flitet shqip.

1 PËRKTHYESJA: Dëgjoni? Dëgjoni tani, z. Haradinaj? Okej.

2 Z. REES: [Përkthim]

3 Py. Atëherë, neve sapo pamë disa prej ngjarjeve të cilat
4 ndodhën që prej fillimit të ndërhyrjes të ZPS-së më datë 24
5 shtator. Z. Gucati dhe z. Haradinaj, sigurisht, që janë
6 arrestuar gjatë kësaj periudhe; a nuk është kështu?

7 Pë. Po, e saktë është?

8 Py. Edhe z. Salih Mustafaj, është arrestuar më 24 shtator; a
9 nuk është kështu?

10 Pë. Korrekt.

11 Py. Dhe ai ka dalë në paraqitjen e parë përpara Gjykatës më
12 datë 28 shtator; apo jo?

13 Pë. Nuk e di. Nuk e mbaj mend përmendësh këtë informacion.

14 Py. Në rregull. Por ju nuk ishit në dijeni, apo jo, që
15 hetuesit dhe juristët tuaj kanë punuar për këtë çështje gjatë
16 kësaj periudhe?

17 Pë. Unë nuk e di se kush kanë qenë hetuesit dhe juristi që
18 janë marrë me procedura gjyqësore në atë kohë.

19 Py. Jo sepse pozicioni juaj, nuk është se përfshin edhe punën
20 me hetuesit dhe prokurorët në këtë kuptim; apo jo?

21 Pë. Siç e thashë, ne kemi qenë shumë të zënë për dy-tre ditë
22 për sa i takon bërjes së telefonatave?

23 Py. Faleminderit. Është një qartësim goxha i dobishëm.

24 Ju na thatë gjithashtu se përdorni mjete të sigurta
25 komunikimi. Çfarë mjetesh të sigurta komunikimi përdorni?

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se nuk
2 ka ndonjë arsye shumë të mirë për këtë gjë, nuk besoj që është
3 pyetje relevante sepse kjo ka të bëjë me proceset e brendshme
4 të punës së ZPS-së.

5 Z. REES: [Përkthim] Unë mund ta shpjegoj relevancën e
6 saj.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në qoftë
8 se do të bëj pyetja në mënyrë të përgjithshme do ta lejoj
9 pyetjen, por në qoftë se do futemi në detaje nuk do ta lejoj
10 pyetjen.

11 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj. Nuk mund të pyes në një
12 mënyrë më të përgjithshme sesa kaq se cila është mënyra e
13 komunikimit. Por relevanca në këtë pyetje është që ZPS-ja
14 javën që shkoi përmendi provat të cilat mund të lidhen me
15 ngjarjet e shtatorit të 2020. Domethënë, qëllimi kryesor i
16 pyetjes time është për të pyetur se cilat janë masat rutinë
17 apo të zakonshme që përdoren pre ZPS-së.

18 Py. Cilat janë mjetet e sigurta të komunikimit?

19 Pë. Ne përdorim ca aplikacione në telefona.

20 Py. Në rregull. A ka raste kur jepni një telefon një individ
21 në mënyrë që ta ndihmoni atë për të ruajtur kontakte me të?

22 Pë. Ka pasur pak raste kur kemi dhënë edhe telefona.

23 Py. Po përpara shtatorit 2020, a i keni dhënë telefona
24 ndonjërit?

25 Pë. Nuk e mbaj mend përpara shtatorit 2020.

1 Py. A do të thotë kjo përgjigje që edhe mund të keni dhënë
2 telefona edhe mund të mos keni dhënë telefona, po nuk mund të
3 më jepni një përgjigje në qoftë se nuk shikoni dokumentet
4 përkatëse?

5 Pë. Po, e saktë është kjo.

6 Py. Atëherë, për sa i takon përdorimit të aplikacioneve të
7 caktuara, nuk do të pyes se cilat janë këto aplikacione ose
8 këto mjete, por përdorimi i këtyre aplikacioneve që ju
9 përmendët a janë pjesë e masave rutinë të sigurisë në mënyrë
10 që komunikimet me dëshmitarët t'i mbani private?

11 Pë. Kjo është pjesë e rutinës tonë, punës së zakonshme tonën.

12 Py. Pra, përdorimi i një aplikacioni të tillë ose
13 aplikacioneve të tilla, është bërë që përpara shtatorit 2020,
14 e keni bërë këtë gjë edhe përpara kësaj kohe apo jo?

15 Pë. Po, e kemi bërë edhe më përpara.

16 Py. Faleminderit. Tani sa i takon ushtrimit që filloi më 24
17 shtator, ju thatë që [REDAKTUAR], që ishte drejtuesi i grupit
18 të sigurisë, kishte dhënë udhëzime që kanë të bëjnë me
19 informacionet ose çfarë informacioni duhej dhënë dëshmitarëve
20 ose çfarë lloj pyetjesh duhet të bëheshin. Në qoftë se
21 dëshironi mund të shohim transkriptin, në qoftë se nuk e mbani
22 mend?

23 Pë. Po, është e saktë kjo.

24 Py. Këto udhëzime ju janë dhënë juve me shkrim, juve edhe anë
25 tareve të tjerë të ekipit të trajtimit të dëshmitarëve?

1 Pë. Jo. Gjatë takimeve që kemi bërë përmes telefonatave.

2 Py. Pra, këto ishin thjesht me gojë, por ndërkohë ndokush a
3 ka mbajtur ndonjë shënim ndërkohë që jepeshin informacione të
4 tjera, udhëzime të tilla?

5 Pë. Nuk ka procesverbal për udhëzime të tilla.

6 Py. Të njëjta udhëzime janë dhënë njësoj të gjithë personave
7 që kanë qenë të përfshirë në ushtrim apo vetëm personave që
8 kanë qenë pjesë e grupit të trajtimit të dëshmitarëve.

9 Pë. Unë kam qenë i pranishëm me oficerët e sigurisë së
10 dëshmitarëve edhe me drejtuesin e ekipit të sigurisë së
11 dëshmitarëve. Nuk di të them për prokurorët dhe hetuesit.

12 Py. E drejtë. Nuk e dini.

13 Atëherë, le të shikojmë pak, notat e kontaktit që keni
14 prodhuar, duke filluar me P134, që është dokumenti me numër
15 identifikimi ERN 091902.

16 Do të fillojmë me këtë dokument sepse në paragrafin 1 të
17 përmbajtjes përmendet një takim me datë 7 shtator 2020; apo
18 jo?

19 Pë. Po. E saktë është kjo.

20 Py. Si një përmbledhje e shkurtër e asaj çfarë u tha, përveç,
21 paragrafëve 4, 5 edhe mbase edhe pjesën e mbetur të paragrafit
22 6 që është e redaktuar, domethënë, nuk mund ta shohim dot se
23 çfarë përmban ky paragraf, nuk mund të shohim dot sesa ka
24 zgjatur kjo gjë. Megjithatë shohim apo dallojmë këtu që një
25 individ tha që "Nuk ka vënë re asgjë të dyshimtë dhe nuk ka

1 identifikuar asnjë problem që prej takimit të fundit me ju".

2 A është kështu?

3 Pë. Po, e saktë është kjo.

4 Py. Dhe kur thotë "takimin e fundit", apo që "nuk ka pasur
5 ndonjë problem që prej takimit të fundit", a mbani mend se kur
6 ka qenë në takimi i fundit ose për çfarë ka qenë takimi i
7 fundit?

8 Pë. Po, e mbaj mend.

9 Py. A ishte takim rutinë?

10 Pë. Pra, është takim për sigurinë e dëshmitarëve pasi dha
11 dëshminë përpara hetuesve të ZPS-së.

12 Py. Në rregull. Pra, nuk kishte pasur ndonjë problem
13 dëshmitari. Këtë thotë dëshmitari. Tani, a mund të shohim pak
14 në fillim të dokumentit kemi një datë aty. Kemi një tabelë me
15 dy kolona dhe me pesë rreshta. Dhe këto janë rreshta të cilat
16 kanë të bëjnë me pjesëmarrësit e ndryshëm.

17 Dhe, në fakt, për këto modele, për këto formularë e
18 kishit fjalën juve kur po thoni që kishte formularë për nota
19 të ndryshme zyrtare?

20 Pë. Po, për këtë lloj formulari e kisha fjalën.

21 Py. Autori thotë, domethënë, thua që autori je ti dhe thua që
22 nuk ka pasur persona të tjerë të pranishëm aty përveç
23 individëve me të cilët kemi folur apo jo?

24 Pë. Po është e saktë kjo.

25 Py. Javën që shkoi ti na the se jeni përpjekur të siguronit,

1 për arsye të dukshme, që takimet apo kontaktet me dëshmitarët
2 potencialë të mund të bëhen në praninë e më shumë sesa një
3 zyrtari të ZPS-së dhe, kjo nuk ndodhte gjatë gjithë kohës, sa
4 p.sh., nuk na thatë kështu?

5 Pë. Po, e saktë.

6 Py. Pra, ky është një shembull që ju jepni që thoni që jeni
7 takuar me një individ një me një; apo jo?

8 Pë. Po. E saktë është kjo.

9 Py. Dhe nuk ka asgjë tek rreshti i referencës që sugjeron që
10 qëllimi i takimit ishte ai që ishte. Domethënë, ju thjesht
11 thoni që është "takimi" pastaj bëhet redaktimi i pjesës së
12 takimit. Ndërkohë që sa i takon rreshtit që i referohet datës,
13 data është 15 shkurt 2021. Dhe kjo synohej të ishte, siç e
14 thatë juve, data në të cilën ju keni bërë notën.

15 Pë. Kjo është data kur kam bërë dorëzimin e dokumentit në
16 ZyLAB.

17 Py. Pra, në këto formularë, në rreshtin data, data që shohim
18 këtu është data kur është regjistruar kjo notë në ZyLAB?

19 Pë. Për këtë notë, po kjo ishte data.

20 Py. Por është në formular. Duhet të jetë në të gjitha notat,
21 apo jo?

22 Pë. Unë nuk jam ekspert për ZyLAB.

23 Py. Mirë në rregull. Do punojmë pak më tepër për të parë se
24 cili është niveli i njohurisë tuaj. Atëherë kjo data këtu,
25 data 15 shkurt 2021, a është data që e ke shkruar ti apo jo?

1 Pë. Mbase e kam shkruar.

2 Py. Mirë atëherë. E lëmë mënjanë faktin në qoftë se je
3 ekspert në ZyLAB apo jo. Por pse në këtë datë, domethënë, në
4 këtë rresht ti ke vendosur datën 15 shkurt 2021?

5 Pë. Mendoj që është gabim.

6 Py. Në qoftë se është gabim, cila duhet të ishte data këtu?

7 Pë. Duhet të ishte 7 shtator 2020.

8 Py. Mirë atëherë, le ta lëmë mënjanë këtë parashtrimin në
9 sistemin ZyLAB. Mund të ketë qenë një gabim dhe duhet të
10 kishit shkruar datën 7 shtator në vend të datës 5 shtator
11 2020, po, në fakt, keni shtypur 15 shkurt 2021. Kur e ke
12 shkruar këtë, domethënë, a bëhej fjalë për 7 shtatorin? Në 7
13 shtator 2020 e ke shkruar ti këtë notë?

14 Pë. Unë e kam shkruar këtë notë më 7 shtator.

15 Py. Edhe është thjesht një gabim, pra, është një gabim i
16 rëndomtë që juve keni vendosur 15 shkurt 2021 apo jo?

17 Pë. Unë e kam dorëzuar, e kam hedhur këtë notë në ZyLAB sepse
18 unë e gjeta, domethënë, pashë që ky njoftim nuk është se ishte
19 regjistruar në ZyLAB.

20 Py. Në rregull. Dhe pastaj çfarë bëre?

21 Pë. Pastaj e regjistrova në ZyLAB.

22 Py. Dhe pastaj çfarë, domethënë, ke ndryshuat datën? Pra, që
23 ishte data 7 shtator dhe ti e ndryshove datën për të lexuar 15
24 mars?

25 Pë. Nuk e mbaj mend këtë gjë.

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 79

1 Py. Nuk është e vërtetë z. Jukiç. Ti nuk ke bërë një shënim
2 për datën 7 shtator dhe ti je përpjekur që të mbash mend edhe
3 pastaj të përgatisësh një notë dhe ke vendosur një datë
4 tjetër?

5 Pë. Jo, nuk është e vërtetë kjo gjë.

6 Py. Le të vazhdojmë me dokumentin tjetër 093386.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A ka një
8 numër P ky dokument?

9 Z. REES: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Është dokumenti
10 P131.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Z. REES: [Përkthim]

14 Py. Një tjetër notë zyrtare që është bërë nga ju. Thuhet në
15 këtë dokument që autori i këtij dokumenti jeni ju?

16 Pë. Po, kështu është.

17 Py. Mund të shohim në paragrafin 1 që thoni që keni marrë një
18 mesazh më datën 8 shtator 2020?

19 Pë. Po, e saktë është kjo.

20 Py. Thuhet këtu që jeni përpjekur ta merrni në telefon
21 personin, e keni provuar dhe njëherë pas gjysmë ore, pastaj
22 thuhet që keni folur me bashkëshorten e personit në orën 9.15
23 më datën 9 shtator dhe pastaj në orën 10.30 keni folur me vetë
24 personin; a është kështu?

25 Pë. Po, e saktë.

1 Py. Ti thua që e qetësove personin. Thoni që dokumentet që
2 janë nxjerrë nuk janë të ZPS-së, janë nga TFHS-ja dhe personi
3 qetësohet disi; këtë po thoni?

4 Pë. Po, këtë them.

5 Py. Në paragrafin 6 kaloni tek një datë tjetër, 22 shtator
6 2020 dhe aty thoni që keni marrë një mesazh nga ky person. A
7 bëhet fjalë për të njëjtin person apo jo?

8 Pë. Po, është i njëjti person.

9 Py. Pastaj jepet një datë e tretë, është 23 shtatori 2020, në
10 paragrafin e fundit të të njëjtës notë dhe në këtë datë ju
11 thoni që e keni marrë në telefon personin për t'i thënë që
12 emri i tij nuk ishte pjesë e dokument që ishin nxjerrë; a
13 është kështu?

14 Pë. Po, kështu është.

15 Py. Atëherë të shikojmë pak datën e këtij dokumenti. Data e
16 këtij dokumenti është 25 shtator 2020; apo jo?

17 Pë. Po, e saktë është.

18 Py. Pyetja e parë është kjo: Nota juaj, pra, është bërë më 8
19 shtator 2020 lidhur me këtë kontakt?

20 Pë. Kjo është një notë që ka të bëjë me kontakte të shumta me
21 të njëjtin person për një periudhë të caktuar kohe.

22 Py. Mendoj që i thatë Trupit Gjykues javën që shkoi dhe na
23 kujtuat edhe sot, që juve bënit një notë zyrtare menjëherë
24 pasi bënit një telefonatë me personat, por këtë gjë nuk e ke
25 bërë më datën 8 shtator; apo jo?

1 Pë. Po, kështu është.

2 Py. Të kalojmë te 22 shtatori. Ku e ke atë notën që e ke
3 shkruar menjëherë mbas kontaktit që ke patur në 22 shtator?
4 Nuk ke bërë një shënim të tillë?

5 Pë. Bëra shënime në këtë notë.

6 Py. Po. Po kjo është përpara ky është momenti më i parë, tre
7 ditë më vonë, 25 shtator? Pra, dua të them që nuk e bërë këtë
8 notë menjëherë mbas 22 shtatorit?

9 Pë. I kisha me vete shënimet në atë kohë.

10 Py. Atëherë, ke dhe dokumente të tjera?

11 Pë. Jo, e kisha fjalën për shënimet me shkrim që kisha
12 mbajtur vetë.

13 Py. Ju thoni që ka dhe diçka tjetër, një dokument tjetër?

14 Z. Jukiç, juve e keni -- po thoni se ju e keni bërë këtë
15 shënim në 8 shtator dhe 22 shtator, për ngjarjet e 8 dhe 22
16 shtatorit tre ditë më pas?

17 Py. Po. Në 25 shtator.

18 Py. Që ta kuptojmë, ju po thoni se notat zyrtare i bënit
19 menjëherë mbas çdo telefoni që keni bërë, tani po thoni që nuk
20 ka ndodhë kështu është e gabuar?

21 Pë. Po.

22 Py. Dhe doni që ne të mendojmë se ju i keni bërë punët
23 seriozisht. Këtë doni të thoni?

24 Pë. Jo, nuk pajtohem me këtë.

25 Py. Është dhe një datë tjetër 23 shtator te paragrafi 8. Ku

1 prapë nuk keni bërë notë zyrtare, parashtrim zyrtar menjëherë
2 mbas kontaktit të 23 shtatorit apo jo?

3 Pë. Siç thashë në atë kohë nuk isha në zyrë dhe këtë notë e
4 dërgova në zyrë në 25. Bëra shumë nota dhe i dërgova.

5 Py. Pra, data që shohim aty ku shënohet data po thoni që
6 është data që e keni bërë datën [sipas përkthimit]?

7 Pë. Ishte data kur unë e përfundova, e finalizova.

8 Py. 25 shtatori? Të shikojmë në anën e majtë. Pse aty thotë
9 15 mars 2020. Në anën e majtë lart.

10 Pë. I rishikova dokumentet në shkurt dhe në mars, në fakt,
11 është një gabim ortografik. Duhet 2021.

12 Py. Atëherë, pse e ka datën 15 mars 2021?

13 Pë. I pashë dhe njëherë dokumentet sepse m'u kërkua të shikoj
14 notat zyrtare nga Prokurori të lidhura me këtë incident. E
15 gjeta këtë notë dhe kur e krahasova me ZyLAB, kur pashë në
16 ZyLAB, nuk e gjeta dhe kjo është data kur unë e dorëzova në
17 ZyLAB.

18 Py. Po nuk e ke dorëzuar në 15 mars këtu në 2020. Do të
19 thuash që e ke dorëzuar në 15 mars 2021?

20 Pë. Po është gabim.

21 Py. Pra, nuk është shtuar nga sistemi ZyLAB? E ke shtypur ti,
22 e ke shënuar ti. Pra, do të thuash që e ke ndryshuar këtë
23 dokument në 15 mars 2021?

24 Pë. Mund ta përsërisni pyetjen?

25 Py. Pra, këtë notë zyrtare e keni ndryshuar në 15 mars të

1 vitit 2021; këtë po thoni?

2 Pë. E kam dorëzuar në 15 mars 2021 në sistemin ZyLAB.

3 Py. Po përpara 15 marsit, kjo data ishte në notë, 15 mars.

4 Pra, ti e ke ndryshuar në 15 mars këtë notë: këtë po thoni?

5 Pë. Është një gabim, siç thashë.

6 Py. Harroje gabimin. Unë po të kërkoj të pohosh se këtë
7 shënim e ke ndryshuar duke shtuar pa të drejtë datën 15 mars
8 në 2021?

9 Pë. A mund ta përsërisni edhe një herë pyetjen? Nuk e kuptoj.

10 Py. Në 15 mars 2021, a e keni ndryshuar këtë notë duke shtuar
11 të paktën datën 15 mars 2020?

12 Pë. Me siguri e kam bërë.

13 Py. Ke ndryshuar ndonjë gjë tjetër në këtë notë?

14 Pë. Nuk kam ndryshuar asgjë.

15 Py. Po ndonjë gjë në nota të tjera a ke ndryshuar ndonjë gjë
16 tjetër?

17 Pë. Nuk ndryshoj asnjëherë asgjë në Nota Zyrtare.

18 Py. Dhe kjo në 15 mars 2021 nuk ishte futur në ZyLAB?

19 Pë. Unë e paraqita atë datë në ZyLAB. Nuk e di me saktësi kur
20 u vendos në ZyLAB por unë ja dorëzova atë ZyLAB.

21 Py. Pra, në 15 mars 2021?

22 Pë. Po.

23 Py. Javën që shkoi thatë që kishte një vonesë sepse nuk ishit
24 -- nuk punonit në zyrë për shkak të pandemisë, kështu është?

25 Pë. Po.

1 Py. Në rregull. Ne ju pamë në zyrë më herët në 27 tetor 2020;
2 apo jo?

3 Pë. Po.

4 Py. Në qoftë se kjo notë ka datë përpara kësaj date, përse
5 nuk e keni dorëzuar atë datë?

6 Pë. Gjatë këtij ushtrimi, shefi i ekipit na kërkoi që t'i
7 dërgonim notat zyrtare me mjete zyrtare dhe ai pastaj kishte
8 për detyrë t'i dorëzonte në ZyLAB.

9 Py. Pra, qenka faji i [REDAKTUAR]? Këtë po thoni?

10 Pë. Nuk po them që është faji i tij.

11 Py. Në 15 mars 2021 e identifikove dhe e dërgove në ZyLAB. Po
12 ju pyes përsëri: Përse nuk e dërguat përpara datës 27 tetor
13 kur ishit në zyrë duke dorëzuar dokumente, pikërisht,
14 deklaratë për këtë çështje?

15 Pë. Sepse e pashë edhe njëherë dosjen. Nuk e kontrollova nëse
16 ishte futur në ZyLAB.

17 Py. A pajtohemi me një gjë, se shpjegimi juaj për këtë gjë ka
18 të bëjë me pandeminë, siç thoni, është gënjeshtër në fakt?

19 Pë. Jo.

20 Py. Ka qenë -- ishte gënjeshtër që ju e menduat për të
21 shpjeguar mospërputhjen e datave, z. Jukiç?

22 Pë. Jo, nuk është e vërtetë.

23 Py. Të shikojmë dokumentin tjetër tani.

24 Z. REES: [Përkthim] P136, ju lutem. Ka numër ERN 093379.

25 Py. Në tekst shoh që përmendni [REDAKTUAR], që ka qenë i

1 pranishëm bashkë me një përkthyes apo përkthyes me numër L-17

2 [sipas përkthimit]; kështu ka qenë?

3 Pë. Po.

4 Py. Është një shembull i një bisede telefonike dhe tregon
5 mesazhet me dikë që përshkruhet si Hasan. Besoj që nuk është
6 dëshmitar është një i afërmi tij; kështu është?

7 Pë. Po.

8 Py. Është shembulli i një personi që nuk ka pranuar asnjë
9 ndihmë dhe këtë e shikoni në paragrafin 2 ku përmendet një
10 mesazh në tekst ku thuhet që:

11 "Nuk ka nevojë të na ndihmoni".

12 E shikoni?

13 Pë. Po, e shikoj.

14 Py. Pastaj mbas këtij mesazhi në 13 shtator, në 14 është
15 regjistruar një bisedë ku Hasani shpreh shqetësime për
16 sigurinë e tij dhe thotë -- nuk e kuptoj mirë ç'thotë, por
17 thotë kështu që:

18 "Ai na tha që nuk bëmë asgjë për një kohë të gjatë".

19 Ky person mos po thoshte që kishte shqetësime që kishin
20 të bënin me datën përpara 7 shtatorit 2020? Atë po thotë këtu?
21 "Që s'ka bërë asgjë për një kohë të gjatë".

22 Me këtë do të thotë me këto fjalë? Nëse nuk e mbani mend,
23 thoni nuk e mbaj mend.

24 Pë. Nuk e mbaj mend.

25 Py. Pra, pajtoheni me mua, se këto fjalë po jua thoshte ju

1 dhe [REDAKTUAR] duke pasur parasysh se kishte kohë -- kishte
2 shqetësime përpara kësaj date dhe se ju s'keni bërë asgjë për
3 një kohë të gjatë; këtë ka dashur të thotë?

4 Pajtoheni me këtë?

5 Pë. A mundet që ta përsërisni?

6 Py. Nga ato që duket, a mund të pajtoheni me mua, kur them se
7 Hasani apo djali i dikujt, nuk e kam të qartë, po thoshte se
8 kishte shqetësime që kishin të bënin me datën përpara datës 7
9 shtator dhe se ZPS-ja nuk kishte bërë asgjë për një kohë të
10 gjatë?

11 Pë. Po, e kishte fjalën përpara 7 shtatorit.

12 Py. Pastaj bëhet fjalë për një telefonatë tjetër, të të birit
13 - thotë tani, që mban datën 24 shtator 2020; pajtoheni?

14 Pë. [Nuk ka përkthim].

15 Py. Kjo Notë Zyrtare nuk është bërë pas kontaktit që keni
16 pasur në 13 shtator; apo jo?

17 Pë. Jo.

18 Py. Po përmende dhe një kontakt të më vonshëm në datën 14 dhe
19 24, pra, nuk u bë mbas kontaktit të parë?

20 Pë. U finalizua mbas kontaktit të parë.

21 Py. Nuk e bëtë, nuk e përgatitët mbas kontaktit të 14
22 shtatorit apo jo?

23 Pë. Nuk e finalizova pas 14 shtatorit.

24 Py. Mbani kështu drafte të këtyre dokumenteve?

25 Pë. Po.

- 1 Py. E dini se ku ndodhen këto drafte?
- 2 Pë. Në USB-në e sigurt që kam unë.
- 3 Py. Në qoftë se bëni, po thoni që keni bërë një notë zyrtare
4 të 13 shtatorit 2020?
- 5 Pë. Po.
- 6 Py. Ku është ai? Besoj që e keni dorëzuar në ZyLAB?
- 7 Pë. Po nuk isha në zyrë në atë kohë.
- 8 Py. Po keni qenë këtu në 27 tetor, po atë ditë e keni
9 dorëzuar në ZyLAB?
- 10 Pë. Këtë notë ja dërgova [REDAKTUAR] përmes komunikimit të
11 sigurt.
- 12 Py. Po [REDAKTUAR], a ju tha sepse ka datën 22 shtator kjo
13 notë?
- 14 Pë. Me siguri ka qenë gabimi im.
- 15 Py. Harro përse. Po tani po ju pyes këtë, a ju tha
16 [REDAKTUAR] "Pse mban datën 22 shtator"?
- 17 Pë. Është gabim, prapë, ortografik.
- 18 Py. A ju pyeti [REDAKTUAR] se "përse dokumenti mban datën 22
19 shtator"?
- 20 Pë. Nuk e kam diskutuar.
- 21 Py. [REDAKTUAR], a ju tha se përse dokumenti ka datën 15 mars
22 2021?
- 23 Pë. Në atë datë [REDAKTUAR] nuk ishte në zyrë.
- 24 Py. Po, por tani jeni duke thënë se ja keni dorëzuar në
25 shtator? Këtë po thoni?

1 Pë. Ja dërgova [REDAKTUAR] në shtator.

2 Py. Dakord. Por kur ja dërgove a nuk të tha ai se përse ky
3 dokument ka datën 14 mars 2021?

4 Pë. Data është -- mban datën 14 mars pasi unë i rishikova dhe
5 gjeta se nuk ishte në ZyLAB kjo notë.

6 Py. Është e vërtetë, apo jo, kjo që po them, se e keni
7 krijuar këtë dokument rreth datës 14 mars kur patë se nuk
8 kishte një notë zyrtare për këtë kontakt dhe e krijuat në
9 atëkohë?

10 Pë. Jo. Nuk është e vërtetë.

11 Py. Mund ta lëmë këtë shpjegimin që thatë se ishte pandemia
12 dhe se nuk kishit mundësi të shkonit në zyrë. Kjo është
13 gënjeshtër.

14 Pë. Nuk është gënjeshtër.

15 Py. Kur keni qenë në zyrë në 27, ju keni qenë në zyrë 27; apo
16 jo? Edhe në janar apo jo?

17 Pë. Po, kam qenë.

18 Py. Përse atëherë nuk i dorëzuat këto nota zyrtare atëherë?

19 Pë. Siç thashë, Notat Zyrtare ja çoja, ja dërgoja shefit të
20 ekipit dhe ishe detyrë e tij t'i dërgonte aty ku duhej. Për
21 shkak të pandemisë nuk vinim në zyrë.

22 Py. Të shohim një dokument tjetër. Është një datë tjetër ku
23 keni qenë në zyrë. Dokument mban numrin P135.

24 Z. REES: [Përkthim] P135, ju lutem.

25 Py. Ky dokument, prapë është një notë zyrtare që keni

1 përgatitur ju, të tjerë të pranishëm ka qenë një prokuror,

2 prokurori britanik vazhdon të punojë ende për ZPS-në ky?

3 Pë. Jo, nuk punon më.

4 Py. Edhe ai e pësoi nga Brexit-i?

5 Pë. Nuk e di. Mbase po.

6 Py. Dhe një përkthyes LA-11. Dhe bëhet fjalë për një kontakt

7 një person, pra, një kontakt me telefon me një person me 24

8 shtator 2020; kështu?

9 Pë. Po, e saktë është.

10 Py. Ai tha që nuk e kish marrë dikush në telefon. Nuk ishte

11 drejtuar dikush, në mesin e paragrafit 2 e thotë këtë.

12 Pë. Po, ashtu është.

13 Py. Megjithëse nuk e kish marrë dikush në telefon, nuk e kish

14 kontaktuar njeri, ai kërkoi që të zhvendosej me gjithë

15 familjen dhe tha që do ta tërhiqte bashkëpunimin në qoftë se

16 ju nuk e zhvendosnit; kështu ka thënë?

17 Pë. Po.

18 Py. Dhe kjo telefonatë ka zgjatur rreth 20 minuta?

19 Pë. Afërsisht.

20 Py. Pastaj bëhet fjalë për një telefonatë tjetër. Kësaj here

21 me një person tjetër. Në paragrafin 3 e keni.

22 Pë. Po, është telefonatë me një person tjetër.

23 Py. Edhe ky thotë që nuk e kish marrë njeri në telefon. Nuk e

24 kish kontaktuar njeri?

25 Pë. E saktë është.

1 Py. Dhe se telefonata ka përfunduar afërsisht mbas 10

2 minutash?

3 Pë. E saktë.

4 Py. Pastaj më 25 shtator, përmendet një kontakt tjetër, 25

5 shtator, nga i njëjti person apo një nga ata të dytë apo i

6 treti?

7 Pë. Nuk e mbaj mend.

8 Py. Dhe për këtë kontaktin e datës 25 shtator, ishte apo jo

9 me ju prokurori britanik?

10 Pë. Nuk e mbaj mend.

11 Py. Teksti në paragrafin 4 nuk e përmend se ka qenë i

12 pranishëm apo jo?

13 Pë. Jo, nuk e përmend.

14 Py. Dhe teksti në paragrafin 3 lidhur me atë telefonatën e

15 dytë, nuk e përmend që i pranishëm ka qenë edhe përkthyesi me

16 numër L-11?

17 Pë. Është e vërtetë.

18 Py. Pra, thotë që bëhet fjalë për kontaktin midis ju dhe

19 vetes -- atij personi dhe ju, prokurori britanik dhe LA-11,

20 pra, nuk është plotësisht e vërtetë?

21 Pë. Dhe është e saktë.

22 Py. Dhe data e dokumentit është 15 shkurt 2021; apo jo?

23 Pë. E saktë.

24 Py. Kjo ishte data kur e keni hartuar këtë notë?

25 Pë. Nuk e mbaj mend.

1 Py. Është e njëjta datë kur keni përgatitur atë notën P134
2 dhe ajo kishte datën 15 shkurt 2021; apo jo?

3 Pë. Po.

4 Py. Ju i keni përgatitur të dyja atë ditë?

5 Pë. Jo. Atë datë unë nuk përgatita nota.

6 Py. Atëherë, pse ju ku keni vënë të dy dokumenteve datën 15
7 shkurt 2021?

8 Pë. Sepse i rishikova dhe gjeta se nuk ishin në ZyLAB.

9 Py. Pra, këtë e mësuar në 15 shkurt se nuk ishte -- kjo notë
10 zyrtare nuk ishte dorëzuar në ZyLAB. Përse nuk e dorëzove në
11 të njëjtën datë dhe P136 që e shqyrtuat dhe atë, përse nuk e
12 dorëzuat në 15 shkurt edhe atë?

13 Pë. Po i rishqyrtoja dhe kur gjeja ndonjë notë që nuk
14 përputhej me databazën që kishim në ZyLAB, e fusja në ZyLAB.

15 Py. Pra, ju keni qenë në zyrë në 27 tetor 2020 dhe nuk i keni
16 dorëzuar nga këto nota atëherë?

17 Pë. Sepse nuk i kisha parë, nuk i pashë, nuk i rishikova në
18 atë kohë.

19 Py. Po në zyrë keni qenë dhe në janar kur keni dorëzuar
20 deklaratën tuaj të dytë dhe nuk i keni dorëzuar këto nota?

21 Pë. Ushtrimin e rishikimit të këtyre notave e filluam në
22 shkurt. Sepse me sa unë dija këto nota ishin futur në ZyLAB.

23 Py. Ju keni qenë në zyrë në 15 shkurt 2021 dhe keni futur
24 nota zyrtare në ZyLAB, por P131 nuk e dorëzuat apo 136 atë
25 ditë?

1 Pë. Nuk e di për cilat nota flisni.

2 Py. Ato që sapo pamë z. Jukiç. Ato ku ju thoni që e
3 ndryshuat, aty ku je, e ndryshuat datën 15 mars 2020, që duhet
4 të kishte qenë 2021; apo jo? Këto dy, për këto dy po flas.

5 Pë. Siç ju thashë, këtë ushtrimin e rishikimit të notave e
6 pamë në shkurt dhe kjo vazhdoi për një farë kohe. Dhe kur e
7 gjeja një notë që s'ishte në ZyLAB e dorëzoja e fusja në
8 ZyLAB.

9 Py. Unë po ju them se në shkurt të kanë kërkuar të filloje të
10 hartoje nota, të cilat e kuptove se nuk i kishe bërë lidhur me
11 kontaktet e dëshmitarit dhe fillove t'i përgatisje në shkurt
12 dhe në mars, prandaj mbajnë edhe datën -- kanë datën disa muaj
13 mbas ngjarjeve. Kjo është e vërteta, apo jo?

14 Pë. Nuk është aspak e vërtetë.

15 Z. REES: [Përkthim] Të shohim tjetrin, P137.

16 Py. Është një tjetër notë zyrtare e përgatitur nga ju, sepse
17 thuhet që ju jeni autori dhe i pranishëm ka qenë dhe dikush,
18 një përkthyes L-01 [sipas përkthimit]; kështu ka qenë?

19 Pë. Po.

20 Py. Teksti shkruan që kontakti është bërë në 3 tetor 2020?

21 Pë. E saktë.

22 Py. Dhe ndër të tjera thoni këtu, se personi ka thënë se
23 askush nuk i është afruar askush nuk e ka kërcënuar dhe nuk
24 ndihet i kërcënuar, pajtoheni me mua?

25 Pë. Po, e saktë është.

1 Py. Dhe megjithëse në rreshtin e modelit që shkruhet data
2 keni një datë që i korrespondon përmbajtjes që është 3 tetor
3 2020. Në krahun e majtë data është përsëri 15 mars 2021, siç e
4 shihni, apo jo?

5 Pë. Po, e saktë është.

6 Py. Kur e keni bërë këtë dokument?

7 Pë. Këtë dokument e kam bërë në 3 tetor 2020.

8 Py. Përse ka datën 15 mars 2021, pra?

9 Pë. Gjatë rishikimit të dokumenteve pashë se kjo notë nuk
10 ishte futur ZyLAB. Vendosa datën 15 mars 2021 në anën e majtë
11 dhe e kam dorëzuar atë ditë në sistemin ZyLAB.

12 Py. Përse atëherë nuk e ke dorëzuar këtë në 27 tetor kur e ke
13 bërë në datën 3?

14 Pë. Këtë notë ia dërgova shefit të ekipit tim dhe unë mendoja
15 se ai e kishte dorëzuar në sistemin ZyLAB.

16 Py. Përse s'na e thatë këtë gjë javës që shkoi?

17 Pë. A mund të jeni më konkret në pyetjet tuaja?

18 Py. Pse nuk na thatë javës që shkoi që këto dokumente janë
19 keni dorëzuar [REDAKTUAR]?

20 Pë. Askush s'ma bëri këtë pyetje.

21 Py. Ju kërkuat të shpjegonit mospërputhjen e datave dhe ju
22 thatë sepse "kjo diferencë në kohë ishte për shkak të
23 lockdown-it dhe nuk lejoheshim të shkonim në zyrë të dorëzonim
24 të gjithë dokumentet".

25 Pë. Disa prej tyre po, por me siguri kjo është dhe arsyeja

1 pse [REDAKTUAR] vetë nuk i ka dorëzuar në ZyLAB.

2 Py. Ju keni qenë në zyrë në tetor dhe në janar dhe në shkurt.

3 Pse s'e keni dorëzuar këtë notë atëherë, në qoftë se kjo që

4 thoni ka ndonjë të vërtetë?

5 Pë. Ju po vini në dukje dëshminë time?

6 Py. Po. Po them se po gënjeni dhe po sajoni lloj-lloj

7 rrëfimesh për të shpjeguar mospërputhjet në data, të cilat unë

8 po ju them që kanë një shpjegim të dukshëm se nga shkurti e

9 tutje ju është kërkuar që të filloni të përgatisni dokumente

10 dhe keni krijuar dokumente për ngjarje që kanë ndodhur, në

11 fakt, muaj përpara, këtë po ju them.

12 Pë. Kjo është plotësisht e gabuar dhe është një gënjeshtër.

13 Z. REES: [Përkthim] Të shohim tani dokumentin 084303, që

14 nuk ka më duket numër P. Por, po të ketë më korrigjoni.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Ka numrin P130.

16 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

17 Py. Ky dokument regjistron një kontakt të drejtpërdrejtë

18 midis jush dhe një personi që me sa duket ka ndodhur në 3

19 tetor 2020; pajtoheni?

20 Pë. Po.

21 Py. Dhe si pjesë e këtij takimi, e pyetët nëse kishte ndonjë

22 shqetësim lidhur me sigurinë e vet dhe siç thuhet është e

23 drejtë, se personi që nuk përmendet emri, nuk kish marrë

24 ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë por se kishte dëgjuar fjalë,

25 thashetheme?

1 Pë. Po, e saktë është.

2 Py. Dhe këtu nuk mban datën 3 tetor por 28 tetor 2020;
3 kështu?

4 Pë. Po, e saktë.

5 Py. Dhe ka datën kur është dorëzuar. Në qoftë se këtë ka për
6 qëllim të tregojë data në krahun e majtë lart, që përputhet me
7 datën 28 tetor 2020; kështu?

8 Pë. Po.

9 Py. Besoj që ju e keni vënë datën aty?

10 Pë. Po, të dorëzimit.

11 Py. E keni shtypur në datën 28 tetor apo e ke shkruar në 15
12 shkurt 2021?

13 Pë. Mund ta përsërisni pyetjen?

14 Py. Datën në anën e majtë lart, e keni shkruar në 20 tetor
15 2020 apo në 15 shkurt 2021 apo në 15 mars 2021? A mund të na
16 ndihmoni?

17 Pë. E kam shkruar në 28 tetor 2020.

18 Py. Në qoftë se ky është një dokument, një Notë Zyrtare e
19 krijuar dhe e dorëzuar po atë ditë, përse nuk dorëzove
20 dokumentin P134 që trajton ngjarjet e 7 shtatorit; P131 që
21 trajton ngjarjet 25 shtatorit; P136 që trajton ngjarjet e
22 datës 13, 14 dhe 24 shtator; P135 që trajton ngjarjet e 24
23 shtatorit dhe 25 shtator; dhe P137 që trajton ngjarjet e datës
24 3 tetor? Përse nuk i dorëzuat këto në 28 tetor kur thoni se
25 keni dorëzuar këtë dokument që po ju pyes?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 96

1 Pë. Shefi im, [REDAKTUAR], nuk ndodhej në zyrë në 3 tetor dhe
2 pas kësaj date nuk kam pasur mundësi t'ia dërgoj këto
3 dokumente askujt. I përfundova në 28 tetor kur vajta në zyrë
4 dhe i dorëzova i futa në ZyLAB.

5 Py. Në qoftë se i keni dorëzuar në 20 tetor, pse nuk keni
6 dorëzuar dokumentet e tjera atëherë në 28 tetor 2020, siç thua
7 kur ekzistonin në atë datë?

8 Pë. Nuk i kam dorëzuar sepse ia kisha dërguar [REDAKTUAR]
9 ndërkohë.

10 Py. Nuk i keni dorëzuar se nuk ekzistonin. Kjo është e
11 vërteta; apo jo?

12 Pë. Jo, nuk është e vërtetë.

13 Z. REES: [Përkthim] A është koha për pushim tani?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të
15 bëjmë pushim për drekë.

16 Sekretare të lutem, shoqëroje dëshmitarin të dali nga
17 salla e gjyqit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
20 i çaktivizuar].

21 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

22 --- Seanca rifillon në orën 14:30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
24 fillojmë, Trupit Gjykues iu bë kërkesë nga Njësia e Shërbimeve
25 Gjuhësore që të kemi parasysh shpejtësinë kur flasim. Ju

1 lutem, të keni parasysh se kur lexojmë, zakonisht, të gjithë
2 kemi tendencë të flasim më shpejt, prisni pesë sekonda para se
3 t'i përgjigjeni një pyetjeje dhe që është më me rëndësi, mos
4 flisni në të njëjtën kohë me një folës tjetër.

5 Dhe, gjithashtu, na është bërë kërkesë që të presim disa
6 sekonda, pesë apo diçka e tillë përpara se të kalojmë nga
7 seancë publike në seancë private. Kështu që, në qoftë se ka
8 njëfarë vonese të vogël, ta keni parasysh pse.

9 Atëherë, të vazhdojmë me dëshmitarin. Zonja Sekretare, ju
10 lutem, silleni dëshmitarin.

11 Z. PACE: [Përkthim] Përpara se të sillet dëshmitari, ju
12 njoftoj se z. HALLING nuk do të jetë i pranishëm në sallë
13 gjatë seancës së pasdites.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni është i
17 fikur].

18 Z. PACE: [Përkthim] Thjesht desha t'ju njoftoj se z.
19 HALLING nuk do të jetë i pranishëm gjatë seancës së pasdites.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Dikush tjetër që nuk është i pranishëm?

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Z. Worboys nuk është për momentin
23 këtu, por do të na bashkohet pak më vonë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni zoti
25 Rees.

- 1 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
- 2 Py. Tani të shikojmë shënimet e kontakteve me radhë
- 3 Z. REES: [Përkthim] P1232.
- 4 Py. Përsëri një shënim zyrtar, z. Jukiç, për një kontakt
- 5 midis jush dhe një individi me anë të telefonit. Njëherë
- 6 mesazh, pastaj thirrje telefonike. Kështu ka shkuar?
- 7 Pë. Po, e saktë.
- 8 Py. Mesazhi i parë mban datën 26 tetor 2020 dhe pastaj
- 9 përmendet në tekst një thirrje telefonike dhe një mesazh
- 10 tjetër më datë 27 tetor. A është e saktë?
- 11 Pë. Po, e saktë.
- 12 Py. Ky shënim zyrtar mban datën 27 tetor 2020. A është e
- 13 saktë?
- 14 Pë. Po.
- 15 Py. Dhe ka një datë në krye të faqes në anën e majtë, 27
- 16 tetor 2020. Çfarë domethënieje ka kjo datë?
- 17 Pë. Kjo është data e dërgimit të këtij shënimi zyrtar në
- 18 sistemin ZyLAB.
- 19 Py. Do t'ju pyes përsëri. Këtë dokument e keni dorëzuar më 27
- 20 tetor, deklaratën më 27 tetor. Pse nuk e keni dorëzuar
- 21 shënimet P134, P131, P136 dhe P135 si dhe P137 në qoftë se ato
- 22 shënime kanë ekzistuar nga data 27 tetor 2020?
- 23 Pë. Nuk mund t'ju them tani, sepse nuk di se për cilat
- 24 shënime e keni fjalën konkretisht.
- 25 Py. Shënimet me datat P134, 15 tetor 2021 që ka të bëjë me

1 një kontakt të 27 shtatorit; P131, data 25 shtator 2020 me një
2 datë tjetër, 15 mars 2020 që ka të bëjë me ngjarjet në shtator
3 2020; P136 mban datën 22 shtator 2020 dhe një datë të
4 mëtejshme 14 mars 2021 dhe ka të bëjë me ngjarjet në shtator
5 dhe kështu me radhë.

6 Pse këto dokumente nuk u dorëzuan me datën 27 tetor të
7 vitit 2020 së bashku me deklaratën tuaj dhe ju thoni, ky
8 shënim zyrtar që shikojmë në ekran tani?

9 Pë. Ky shënim zyrtar që shohim në ekran nuk ishte pjesë e
10 deklaratës sime sepse, siç e shihni, është dorëzuar më datën
11 27 dhe shënimi im, apo më mirë të them deklaratë ime është
12 përpiluar një ditë më parë dhe unë e kam nënshkruar të
13 nesërmen në mëngjes, me sa më kujtohet.

14 Py. Por e kanë datën e njëjtë, 27 tetor 2020, apo jo?

15 Pë. Data është e njëjtë, por koha nuk është e njëjtë.

16 Py. Atëherë, çfarë kohe është e shënuar në atë dokument?

17 Pë. Ju e shikoni se thirrja telefonike e fundit me këtë
18 dëshmitar që përmendet në këtë shënim është regjistruar në
19 orën 16.51.

20 Py. Sipas përmbajtjes së shënimit, dëshmitari ka kërkuar nga
21 ZPS-ja që të paguajë për faturat mjekësore. A është kjo e
22 saktë?

23 Pë. Na ka dorëzuar dokumentacionin mjekësor dhe faturat dhe
24 na ka pyetur në qoftë se ZPS-ja ka mundësi t'i paguajë ato
25 fatura.

1 Py. Domethënë, ua ka dhënë faturat dhe ju ka kërkuar që t'i
2 paguani. A i keni paguar ato?

3 Pë. I kemi paguar faturat.

4 Py. Po? Atëherë, sa keni paguar?

5 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e shoh rëndësinë e asaj sesa ka
6 kushtuar, sa kanë kushtuar këto fatura, sa është paguar për
7 to?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokat.

9 Z. REES: [Përkthim] Ka të bëjë me kredibilitetin.

10 Py. Zoti dëshmitar, sa keni paguar?

11 Pë. Nuk mund t'ju them saktësisht, por përafërsisht 400 euro.

12 Py. Dhe ku janë ato faturat tani? I dini, apo jo?

13 Pë. Janë në sistemin ZyLAB.

14 Py. Ju kujtohen datat e atyre faturave, apo jo?

15 Pë. Jo, nuk më kujtohen.

16 Z. REES: [Përkthim] Atëherë, të shikojmë shënimin e
17 ardhshëm. Numri i regjistrimit të provës është ERN 089909. Nuk
18 kam numrin e provës. Në qoftë se ekziston një numër prove për
19 këtë dokument, lus sekretaren të ma tregojë.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jo, nuk ka numër të
21 provës.

22 Z. REES: [Përkthim] Në rregull. Atëherë, është një
23 dokument pa numër prove. Të presim të paraqitet në ekran.

24 Py. Është një datë pak më e vonshme, në dhjetor. Është shënim
25 zyrtar. Autor jeni ju vetë. Përmenden të pranishmit. Njëri

1 prej tyre është një hetues i ZPS-së, emrin e atij personi e
2 kemi parë më herët. Dhe përmbajtja e shënimit zyrtar i
3 referohet kontaktit të datës 1 dhjetor 2020; kështu?

4 Pë. E saktë.

5 Py. Ju e keni thirrur këtë individ dhe e keni informuar që
6 emri i tij kishte rrjedhur në media dhe në shënim thuhet, ai
7 tha:

8 "Sipas mendimit të tij, ishte sigurisht emri i tij..."

9 Çfarë do të thotë kjo? A kishte ndonjë farë dyshimi se a
10 ishte, apo jo emri i tij?

11 Pë. Nuk më kujtohet kjo.

12 Py. E shikoni këtë rreshtin që jua lexova: "Sipas mendimit të
13 tij, thuhet, ishte e sigurt që ishte emri i tij...". Ishte i
14 sigurt ai që ishte emri i tij, apo jo?

15 Pë. Ai ishte i sigurt. Kështu që ishte i sigurt. Ashtu
16 shkruan.

17 Py. Po ju, a ishit të sigurt se ishte emri i tij?

18 Pë. Po, isha.

19 Py. Pra, ai ju tha që nuk kishte lidhje që kishte dalë emri i
20 tij dhe se nuk kishte marrë kurrfarë kërcënimi. A është
21 kështu?

22 Pë. Po.

23 Py. A është ky shënim që është shkruar më datën 1 dhjetor
24 dhe është dorëzuar në ZyLAB të njëjtën datë?

25 Pë. Në qoftë se shkruhet ashtu, ashtu është.

1 Py. Por aty del edhe një datë tjetër, shkurt dhe mars 2021
2 kur ju keni mundur të vendosni dokumentet në ZyLAB; apo jo?

3 Pë. Po, ashtu është.

4 Z. REES: [Përkthim Tani të shikojmë dokumentin me numër
5 P133.

6 Py. Është një shënim zyrtar tjetër i datës 3 dhjetor 2020 që
7 përmban të dhëna për kontaktet ku keni qenë të përfshirë ju
8 dhe një hetues. Koha është, pra, periudha kohore, 3 dhjetor.
9 Ju e keni informuar individin se emri i tij ka dalë në media
10 dhe ai ka thënë që nuk është mërzhitur, se nuk kishte marrë
11 kurrfarë kërcënimi dhe se s'kishte shqetësime lidhur me
12 sigurinë. A është kështu?

13 Pë. Po.

14 Py. Dhe ky është dokument që mban datën 3 dhjetor. Ju thoni
15 që e keni përpiluar atë ditë?

16 Pë. Po.

17 Py. Dhe e keni dorëzuar me 3 dhjetor?

18 Pë. Po.

19 Py. Dhe një datë tjetër para shkurtit dhe marsit 2021 kur
20 keni qenë në gjendje të dorëzoni shënimet zyrtare në sistemin
21 ZyLAB; a është kështu?

22 Pë. Po.

23 Py. Tani të shikojmë dokumentin me numër 0902064. Nuk kam
24 numër prove për këtë dokument. Na thotë Sekretarja në qoftë se
25 ekziston një numër prove.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nuk ka numër prove për
2 këtë dokument.

3 Z. REES: [Përkthim]

4 Py. Këto dokumente u përmendën gjatë pyetjeve të Prokurorisë,
5 por nuk u paraqitën si prova.

6 Përsëri edhe ky Shënim është që e keni përpiluar ju, pra,
7 ju jeni autori. Është përfshirë në të edhe i njëjti hetues.

8 Mban datën 5 dhjetor 2020 dhe ka lidhje me një kontakt, me një
9 individ që ka ndodhur në të njëjtën ditë; kështu?

10 Pë. Po.

11 Py. Dhe ai person ka thënë që nuk ka frikë, nuk ka shqetësime
12 në lidhje me sigurinë, asnjëherë s'e ka ndjerë veten të
13 kërcënuar në Kosovë, se i vetmi kërcënim për të kanë qenë
14 serbët gjatë luftës. A është kështu?

15 Pë. Po, e saktë, ashtu ka thënë.

16 Py. Dhe data është ne krye të faqes nga ana e majtë, 5
17 dhjetor 2020. A është dorëzuar në ZyLAB në të njëjtën datë?

18 Pë. E saktë.

19 Py. Përsëri edhe një datë që ju, pavarësisht nga pandemia
20 keni mundur ta dorëzoni këtë dokument në ZyLAB. A është kjo e
21 saktë?

22 Pë. Po.

23 Py. Tani do t'u kthehem edhe disa prej këtyre dokumenteve.

24 Kur them "dy", e kisha fjalën për kuptimin "dy" në Uellsh,
25 domethënë, disa, dua të them.

1 Z. REES: [Përkthim] T'i kthehemi edhe njëherë, zonja
2 Sekretare, dokumentit P135.

3 Gjatë pauzës së drekës u bë një kërkesë për përgatitjen e
4 një liste me shkrim të emrave, në mënyrë që të ndihmohet
5 stenografi dhe këtë e kemi bërë. Dhe këtë e kemi bërë, e kemi
6 futur në sistem elektronik të Gjykatës.

7 Tani kërkoj që kjo listë të vendoset në ekran përbri
8 shënimit zyrtar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
10 për shpjegimin.

11 Z. REES: [Përkthim] Do të kalojmë në seancë private në
12 qoftë se përgjigjja e dëshmitarit është pohuese. Për momentin,
13 preferoj të mbetemi në seancë publike.

14 Py. Dëshmitar, a e shikoni se në shënimin zyrtar në lidhje me
15 paragrafin 2 dhe kontaktin me një person më datën 24 shtator,
16 në shënim thuhet se një prokuror britanik ka qenë i pranishëm
17 për atë thirrje telefonike dhe e ka informuar individin që
18 emri i tij ishte bërë publik në mediat kosovare.

19 Ju kujtohet që i përmenda emrat nga një listë emrash që
20 ishin bërë publike në media sot në mëngjes?

21 Pë. Po, më kujtohet.

22 Py. Tani e keni këtë listë me shkrim, në anën e majtë të
23 ekranit. Thjesht, shikojeni njëherë këtë listë dhe më thoni:
24 "Po", "jo", "nuk më kujtohet" në pyetjen në vijim. Personi të
25 cilit iu tha që emri i ishte bërë publik në mediat e Kosovës,

1 emri i këtij personi a paraqitet në listën nga ana e majtë?

2 Z. PACE: [Përkthim] Dëshmitari sot në mëngjes u përgjigj
3 se nuk i kujtohen emrat dhe tani mbrojtësi po e pyet
4 dëshmitarin në qoftë se emrat që dalin në anën e majtë të
5 ekranit janë të redaktuar në anën e djathtë dhe kjo nuk është
6 me vend.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
8 hidhet poshtë.

9 Mund të vazhdoni, zoti REES.

10 Z. REES: [Përkthim]

11 Py. Shikoni listën nga ana e majtë. Personat emrat e të
12 cilëve janë përfshirë në listën në anën e majtë, a janë emrat
13 e tyre të kontaktuar më 24 shtator dhe të cilëve iu tha që
14 emrat u kishin dalë publikisht në media?

15 Pë. Jo.

16 Py. Ju faleminderit.

17 Z. REES: [Përkthim] Të shikojmë dokumentin P135, ta lëmë
18 listën në ekran. Më falni, jo P135-n, sepse sapo e pamë atë
19 dokument. Të shikojmë dokumentin me numër 089909.

20 Py. Në paragrafin 2, sipas shënimit zyrtar, ky individ dhe ky
21 është një individ -- pyetja ime është, a është i njëjti, apo
22 si ai tek shënimi që pamë përpara, apo ndonjë person tjetër?

23 Pë. Është një person tjetër.

24 Py. Pra, këtij individ iu tha që emri i tij kishte dalë në
25 media. Dhe përsëri më përgjigjeni me "po", "jo", "nuk e di",

1 në qoftë se emri i tij paraqitet në listën në të majtë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Thjesht dua të di, të nderuar
3 Gjykatës, në qoftë se Trupi Gjykues lejon këto pyetje, a do të
4 thotë kjo se urdhri i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për
5 mosnxjerrjen e këtyre emrave është pezulluar? Sepse, me sa
6 kuptojmë ne, kjo nuk lejohet sipas atij urdhri.

7 Dëshmitari tashmë është përgjigjur se nuk i kujtohet nëse
8 personat, emrat e të cilëve janë përfshirë në listën në të
9 majtë, janë kontaktuar apo jo. Dhe ky është pikërisht vetë
10 dëshmitari, personi që mund të thotë nëse ata persona janë
11 kontaktuar ose jo.

12 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke marrë
14 parasysh rrethanat, Trupi Gjykues do ta lejojë përgjigjen.

15 Njëri prej të akuzuarve, klienti i z. Rees akuzohet për
16 nxjerrjen e emrave - numër një - dhe numër dy, nuk ekziston
17 mënyrë tjetër për të marrë këtë informacion, sepse ai nuk i ka
18 të gjithë emrat që janë të përfshirë në redaktime.

19 Kështu që, nëse e dini përgjigjen, ju lutem të na e
20 jepni.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Përgjigjja ime është jo.

22 Z. REES: [Përkthim] Ta lemë përsëri listën në anën e
23 majtë të ekranit aty. Të shikojmë përbri dokumentin me numër
24 089908.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për hir të

1 procesverbalit, është dokumenti me numrin e provës P133.

2 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti PACE, në
4 qoftë se dëshironi, ju mund të bëni kundërshtime në lidhje me
5 këtë lloj pyetjesh, nëse dëshironi.

6 Z. PACE: [Përkthim] Po, dëshiroj, i nderuar Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Z. REES:

9 Py. Tani te ky shënim a bëhet fjalë për një kontakt me një
10 person tjetër, apo me personin e njëjtë?

11 Pë. Është kontakt me person tjetër.

12 Py. Dhe në paragrafin 2, aty e shohim se atij i është thënë
13 që emri i tij kishte dalë në media. Pyetja është, emri i këtij
14 personi a paraqitet në anën e majtë të ekranit, apo jo? "Po",
15 "jo", "nuk e di".

16 Pë. Jo.

17 Py. Përgatitja e listës që ju e keni përdorur si bazë për
18 këto kontakte, kontaktime, ju na thatë që ju konkretisht nuk e
19 dini se mbi çfarë materiali e përpiloi [REDAKTUAR] atë listë;
20 është kështu?

21 Pë. Po, e saktë.

22 Z. REES: [Përkthim] Në lidhje me dokumentin numër P135
23 dhe do t'i kthehem shkurtimisht këtij dokumenti. Ta vendosim
24 edhe njëherë në ekran. Pra, P135.

25 Py. Individit që përmendët në paragrafin 2 të këtij shënimi

1 zyrtar që ka kërkuar zhvendosje, apo shpërngulje, ky person a
2 u zhvendos, a u shpërngul?

3 Pë. Jo.

4 Py. Ky person, a është dikush që ka një të kaluar kriminale,
5 apo nuk e dini?

6 Pë. Nuk e di.

7 Z. REES: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që shkoj, kthehem te
8 dokumente të mëparshme. Të shikojmë përsëri, shkurtimisht,
9 dokumentin P133.

10 Py. A e shikoni emrin e hetuesit që përmendët aty?

11 Pë. Po, e shikoj emrin e hetuesit.

12 Py. A mund të na ndihmoni rreth atij personi? Çfarë roli ka
13 ai?

14 Pë. Është hetues pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

15 Py. Ka një ekip hetuesish në Zyrën e Prokurorit të
16 Specializuar; e saktë?

17 Pë. Po, e saktë.

18 Py. Ai nuk është hetuesi i vetëm, apo jo? Çfarë detyrash ka
19 ai?

20 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtoj mbi bazë të relevancës
21 së kësaj pyetjeje. Dëshmitari nuk është ky person që përmendet
22 në dokument, as nuk është eprori i tij, me sa e di unë. Dhe se
23 çfarë mendon ky dëshmitar lidhur me detyrat e kolegut të vet,
24 nuk ka kurrfarë relevance.

25 Z. REES: [Përkthim] Atëherë, do ta filloj pyetjen

1 ndryshe.

2 Py. Dëshmitar, a e dini se cilat janë detyrat e atij hetuesi?

3 Pë. Unë, sikurse e thashë, e di që ai është hetues në Zyrën e
4 Prokurorit të Specializuar.

5 Py. Pra, nuk ka asnjë gjë të veçantë lidhur me rolin e tij?

6 Pë. Ai si edhe gjithë të tjerët, hetuesit e tjerë, është
7 hetues pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

8 Py. Dhe sa hetues ka në atë zyrë?

9 Z. PACE: [Përkthim] Cila është rëndësia e numrit të
10 personave të punësuar si hetues në ZPS?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila është
12 rëndësia, z. REES?

13 Z. REES: Ky hetues, sikurse të gjithë e dimë, është
14 dikush që potencialisht mund të japë dëshmi në lidhje me
15 çështjet për të cilat do të dëshmojë dëshmitari i ardhshëm.
16 Dhe i vetmi shpjegim nga Zyra e Prokurorit se pse nuk është
17 ftuar për dëshmitar për të dhënë dëshmi është se ai person
18 është dikush që ka një rol unik apo detyra të veçanta. Dhe,
19 thjesht, po e pyes këtë dëshmitar në qoftë se ai, në bazë të
20 njohurive që ka, sheh diçka unike në lidhje me rolin dhe
21 detyrat e atij hetuesi.

22 Z. PACE: [Përkthim] Për vendimet dhe për parashtrimet që
23 bën Mbrojtësi, tashmë është marrë një vendim. Se cilin do ta
24 thërrasë Prokurori për të dhënë dëshmi është detyrë e
25 prokurorisë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti REES,
2 ju na e treguat atë që ju mendoni se është relevante dhe aty
3 nuk ka kurrfarë shpjegimi. Dhe dëshmia e këtij dëshmitari nuk
4 mund të shtojë asgjë në atë drejtim.

5 Z. REES: [Përkthim] Çfarëdo -- detyrat e këtij personi,
6 dua të dëgjoj mendimin e dëshmitarit në lidhje me to.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë doni të
8 arrini me këtë?

9 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pyetjet mund të
10 shkojnë në drejtim të ndryshëm, varësisht nga përgjigjja e
11 dëshmitarit. Vetë sugjerimi nga Prokuroria se ai hetim ka një
12 rol të veçantë, është diçka që unë dua ta hetoj më tej. Unë
13 dua, thjesht, ta pyes zotin Jukiç nëse ai e di se çfarë është
14 ky rol unik i atij personi.

15 Në qoftë se zoti Jukiç thotë se nuk ka asgjë unike rreth
16 detyrave të atij hetuesi, apo roli i tij, atëherë, unë do të
17 vazhdoj me ndonjë aspekt tjetër të pyetjeve.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Atëherë, vazhdoni.

20 Z. REES: [Përkthim]
21 Py. Ka dy nota për të cilat ju pyetën javës që shkoi. Ju
22 thatë se nuk i keni përgatitur ju, por i keni parë.

23 Z. REES: [Përkthim] Njëra është 084232.
24 Py. Është një notë e përgatitur nga një ndihmësprokuror i një
25 kontakti ku ju keni qenë i pranishëm me përkthyesin. Të shohim

1 paragrafin 4 të kësaj note, ku thuhet se personi që është
2 kontaktuar u pyet nëse i kishte ndodhur diçka javët e fundit,
3 për t'u shqetësuar. Dhe ai tha, asgjë nuk ka ndodhur dhe nuk
4 priste të ndodhte ndonjë gjë shqetësuese. Dhe kjo mban datën
5 26 tetor; kështu?

6 Pë. Po, ashtu është.

7 Py. Më tej thuhet se -- tek 092914, te një notë tjetër, pra,
8 kësaj here është një notë të cilën e ka përgatitur hetuesi për
9 të cilin po diskutojmë. Ka një referencë ndaj template-it,
10 modelit, për datën, që mban datën 20 dhjetor 2020, më fal 3
11 dhjetor 2020, pastaj ka një datë tjetër në fillim, në krahun e
12 majtë, që thotë 9 mars 2021. S'po të pyes për datat, por për
13 përmbajtjen.

14 Pra, ka lidhje me 3 dhjetorin, ku personi për të cilin,
15 me të cilin keni folur tha se nuk kam marrë ndonjë kërcënim.

16 Pë. E saktë.

17 Py. Por është edhe një notë tjetër që është trajtuar me ju,
18 edhe pse ju nuk dilni aty, emri juaj s'del. Është nota me
19 numrin 084247. Nuk ka nevojë që ta tregoni. Është një notë ku
20 juve nuk e keni hartuar, por keni qenë i pranishëm si
21 vëzhgues. E mbani mend?

22 Pë. Po. Isha i pranishëm në dhomë.

23 Py. Ishe i pranishëm në dhomë?

24 Pë. Por nuk isha pjesë e bisedës së zhvilluar.

25 Py. Individit në fjalë e dinte që ti ishe i pranishëm?

- 1 Pë. Besoj që po.
- 2 Py. Pse thua që "besoj se e dinte"? Pse duhet të kesh dyshim,
3 nëse e dini që ishe i pranishëm?
- 4 Pë. Nuk e di nëse kisha dijeni që isha, por unë isha aty në
5 dhomë.
- 6 Py. Sa e madhe është dhoma?
- 7 Pë. Mbase 20 metra katrorë.
- 8 Py. Pra, një dhomë e madhe?
- 9 Pë. Po, 20 metra katrorë.
- 10 Py. Pra, 4x5, i bie, 4x5m. Pra, ti ishe në dhomë, por nuk e
11 di nëse dëshmitari e dinte?
- 12 Pë. Dëshmitari e dinte që unë isha në dhomë.
- 13 Py. Dhe ndihmësprokurori që hartoi këtë notë e dinte që ishe
14 i pranishëm?
- 15 Pë. Ajo më pa.
- 16 Py. Edhe zëvendësprokurori?
- 17 Pë. Edhe ai më pa.
- 18 Py. Nuk di ta shpjegoj se pse nuk je shënuar edhe ti si i
19 pranishëm aty, përderisa listohet autori, të pranishmit në
20 këtë notë?
- 21 Pë. Po, e saktë, ashtu është. Por unë nuk e di pse
22 zëvendësprokurori nuk më përfshiu edhe mua në atë notë.
- 23 Py. Se ka futur përkthyesin si një i pranishëm tjetër.
- 24 Pë. Nuk e kam përpara notën. Nuk mund të them.
- 25 Py. Do ta shfaqim menjëherë.

1 Z. REES: [Përkthim] Është numri 084247.

2 Py. Pra, aty shikohet në titull, modeli, template, pra. Ka
3 rreshta ku shënohet autori, zëvendësprokurori, ka edhe një
4 kuti për të pranishmit e tjerë. Zëvendësprokurori, përkthyesi
5 LA-17 dhe përmenden edhe në tekst, në paragrafin 1, gjithashtu
6 përmenden. Kurse ti nuk je aty.

7 Pë. E saktë.

8 Py. Po ti dëgjoje me një pajisje dëgjimi, mbase? Mos nuk ke
9 qenë në dhomë dhe ke dëgjuar nga një vend tjetër atë që po
10 ndodhte?

11 Pë. Jo, nuk është e saktë.

12 Py. Apo e ke parë me video-kamera që e ka regjistruar dhe e
13 ke parë nga një dhomë tjetër?

14 Pë. Nuk i regjistrojmë kurrë takimet me dëshmitarët në video.

15 Py. Apo e thatë këtë kur zoti Pace ju pyeti dhe ju tha që
16 keni ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë?

17 Pë. E bëjmë shumë rrallë këtë, por në këtë rast, jo.

18 Py. Javës që shkoi the se një nga dëshmitarët foli me ty dhe
19 tha që "e di shumë mirë se çfarë u ndodh dëshmitarëve në
20 Kosovë". Të kujtohet që ia ke thënë këtë gjë Trupit Gjykues?

21 Pë. Po, e mbaj mend.

22 Py. Dhe kjo ndodhi në fillim, kjo telefonatë që e morët nga
23 një dëshmitar, nga një person që e quan dëshmitar, por jo që e
24 ke kontaktuar vetë?

25 Pë. Po, është e saktë.

1 Py. Ne i kemi parë shënimet e takimit dhe kemi parë që ke
2 zhvilluar një takim, ke marrë një telefonatë nga një dëshmitar
3 dhe një nga një kushëri i tij përpara 24 shtatorit, kur
4 filluat që t'i merrni vetë në telefon njerëzit. Dhe në asnjë
5 nga këto shënime apo nota nuk mbaj mend që dëshmitari të ketë
6 thënë se "e di shumë mirë se çfarë u ka ndodhur dëshmitarëve
7 në Kosovë". Të kujtohet kjo?

8 Pë. Nuk gjendet në këto shënime të kontakteve.

9 Py. Në asnjë shënim tjetër nuk ndodhet. Po këtë e sajove nga
10 mendja javës tjetër?

11 Pë. A mund ta përsërisni pyetjen?

12 Py. Nuk mbani mend asnjë shënim kontakti ku t'u ketë thënë
13 dëshmitari që "unë e di shumë mirë se çfarë u ndodh
14 dëshmitarëve në Kosovë", apo e ke bërë ti, e ke sajuar ti?

15 Pë. Unë e kam shënuar këtu në disa nga shënimet.

16 Py. Do që t'i shikosh edhe njëherë shënimet që ke mbajtur ti?
17 Por nuk pranon të thuash se asnjë nga dëshmitarët të ketë
18 thënë që "e di shumë mirë se çfarë u ka ndodhur dëshmitarëve
19 në Kosovë"?

20 Pë. E mbaj mend nga një bisedë me një dëshmitar, por nuk mund
21 të them nëse ndodhet në notat që i kam paraqitur Trupit
22 Gjykues.

23 Py. Mbase e mbani mend, pra, nga ç'ju kujtohet nga ato
24 ngjarje të ndodhura para një viti, por për të cilat ju nuk
25 keni mbajtur, nuk keni hartuar asnjë notë.

1 Z. PACE: [Përkthim] Janë bërë këto pyetje dhe kanë marrë
2 përgjigje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

4 Z. REES: [Përkthim]

5 Py. Ju thatë se të gjithë personat që ju kontaktuan ishin të
6 trembur.

7 Pë. Po, ashtu thashë.

8 Py. Po ky dëshmitari që në shënimin tënd P134, që ka folur me
9 ty më 7 shtator 2020, ka thënë që:

10 "Nuk kam pasur ndonjë, nuk kam vënë re ndonjë dyshim dhe
11 nuk kam pasur ndonjë problem".

12 Pë. Është fjala për telefon, apo për takim?

13 Py. Për takim.

14 Pë. Unë thashë që të gjithë dëshmitarët që më morën në
15 telefon ishin të trembur.

16 Py. Po ai djali që ishte P136 që tha "Nuk kemi nevojë për
17 ndihmën tuaj." Nuk shprehu ky që ishin të frikësuar.

18 Pë. Jo, sepse e tha "nuk kemi nevojë për ndihmë nga ju".

19 Py. Pra, ishte ekzagjerim kur the që të gjithë personat që na
20 kontaktuan ishin të trembur?

21 Pë. Ai djali nuk më mori në telefon mua. Unë e mora atë në
22 telefon.

23 Py. Në dëshminë që dhe javës tjetër, the se lidhur me masat e
24 marra si rezultat i ushtrimit të 24 shtatorit, disa dëshmitarë
25 që nuk kishin mundësi t'ju kontaktonin, "atyre u dhamë

1 telefona".

2 Dua t'ju pyes prapë, mbase ke pasur kohë të mendohesh
3 tani, sa dëshmitarëve, personave që kishit kontaktuar, ju
4 kishit dhënë telefona përpara shtatorit të vitit 2020?

5 Pë. Mbase një apo dy.

6 Py. Po më mbas, save ju dhatë? Mund të thoni, apo s'ju
7 kujtohet?

8 Pë. Të themi nga pesë deri në dhjetë. Realisht nuk e di
9 numrin me saktësi.

10 Py. Po nuk mbani ju shënime për vendimet që merrni kur i
11 jepni një telefon një dëshmitari?

12 Pë. Është e shënuar në notën zyrtare.

13 Py. Por nuk është në asnjë nga notat zyrtare që pamë, apo që
14 na janë nxjerrë ne si mbrojtje.

15 Z. PACE: [Përkthim] Është argumentative dhe nuk është
16 pyetje e duhur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

18 Z. REES: [Përkthim]

19 Py. Kur thoni që regjistrohet në Notën Zyrtare, zoti Jukiç,
20 nuk e keni fjalën për këto Nota Zyrtare, për kontaktet, se
21 asnjë prej tyre nuk regjistron që një dëshmitari i është dhënë
22 telefon?

23 Pë. Të gjithë këto nota zyrtare që janë paraqitur këtu lidhen
24 me kontaktet që kanë të bëjnë me botimin e dokumenteve nga OVL
25 UÇK-ja. Këto nota zyrtare, siç thashë përpara, mbas çdo

1 kontakti hartojmë një notë zyrtare. Dhe këto telefona u dhanë
2 më pas.

3 Py. E kuptoj. Mund t'u jenë dhënë dëshmitarëve më pas, por
4 këto nuk lidhen me ngjarjet e shtatorit 2020.

5 Pë. Ju dhanë atyre për shkak të incidenteve të ndodhur në
6 shtator të vitit 2020.

7 Py. Ashtu? Por nuk keni asnjë të dhënë, dokument, për ta
8 treguar nga ana juaj.

9 Z. PACE: [Përkthim] Nuk po citon ato që thotë dëshmitari.
10 Ai e përcaktoi që flitet për notat e kontakteve, kështu që nuk
11 është një pyetje e duhur. Mbase mund ta riformulojë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të jap
13 vendim.

14 Kundërshtimi nuk pranohet. Vazhdoni me pyetjet.

15 Z. REES: [Përkthim]

16 Py. Do të na tregoni ndonjë dokument që të tregojë që të këtë
17 procesverbal të një telefoni që i është dhënë një dëshmitari
18 dhe që lidhet me ngjarjet e shtatorit 2020?

19 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Siç keni dhënë përpara,
20 në raste të tjera, edhe kjo nuk ka të bëjë me dokumentet për
21 të cilat po jep dëshmi dëshmitari.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranoj.

23 Z. REES: [Përkthim]

24 Py. Unë nuk po ju kërkoj të bëni diçka. Unë po ju kërkoj të
25 përgjigjeni "po" apo "jo". Do të na jepni ndonjë dokument?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranova
2 kundërshtimin.

3 Z. REES: [Përkthim]

4 Py. Pra, plani emergjent i rrezikut. Ju na thatë se kjo bëhet
5 në rastin e dëshmitarëve që përcaktohen se janë shumë të
6 cenueshëm, të pambrojtur, por edhe janë të rëndësishëm për
7 Zyrën e Prokurorisë. E mbani mend këtë?

8 Pë. Po, e mbaj mend.

9 Py. Por asgjë në këto nota të kontakteve, lidhur me
10 përgatitjen e planit të riskut emergjent, nuk ka asgjë për
11 këto. Pra, po pranoj atë që keni thënë ju. A kishte plane të
12 tilla për dëshmitarët përpara 7 shtatorit 2020?

13 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se avokati mund të jetë më i
14 qartë. Në qoftë se e ka fjalën për vitet e kaluara që ne kemi
15 punuar, në qoftë se flet në përgjithësi, nuk është relevante.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.
17 Kufizojeni pyetjen.

18 Z. REES: [Përkthim]

19 Py. A kishte ndonjë plan për rrezikun emergjent për çdo
20 dëshmitar përpara 7 shtatorit 2020, pra, gjatë dy viteve para
21 shtatorit 2020?

22 Z. PACE: [Përkthim] Është pyetje shumë e gjerë, mbulon
23 një periudhë të gjatë kohe dhe relevanca është përcaktuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
25 vazhdoni.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, kishte dy apo tre plane të
2 tilla.

3 Z. REES: [Përkthim]

4 Py. A mbani procesverbale, dokumente për këto plane?

5 Pë. Po i mbajmë.

6 Py. Dhe për procesin e vendimmarrjes për një plan të tillë?

7 Pë. Jo, nuk kemi dokumente të procesit vendimmarrës për
8 hartimin e këtyre planeve.

9 Py. Pra, nuk mbani dokumente? Dhe pastaj u pyetët për nivelin
10 e riskut, apo të rrezikut. A ka ndonjë shkallë, apo tabelë ku
11 përcaktohen nivelet e ndryshme të rrezikut të cilat përdoren
12 prej jush?

13 Pë. Ne përdorim tabelat e zakonshme të nivelit të kërcënimit
14 që përdoren normalisht.

15 Py. Pra, na ndihmoni, mirë. Pra, ka një tabelë. A mund t'i
16 shikojmë të gjithë nivelet, të na flisni për të gjithë nivelet
17 e kësaj tabele?

18 Pë. Tani nuk jam i përgatitur, por mund të provoj.

19 Py. Të lutem, provoje. Do ta kemi parasysh. Përpiquni të na
20 ndihmoni për nivele të ndryshme të kërcënimit.

21 Pë. Kemi i ulët, i mesëm, i lartë dhe shumë i lartë, risk.

22 Py. Përsëri, do të na tregoni ndonjë dokument që ky plan
23 është krijuar në përgjigje të ngjarjeve të shtatorit të 2020-
24 ës, apo doni të pranojmë përgjigjen tuaj?

25 Z. PACE: [Përkthim] Ju keni dhënë vendim për këto lloj

1 pyetjesh.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranoj.

3 Z. REES:

4 Py. Çfarë dallimi ka midis një punonjësi të sigurisë së
5 dëshmitarëve dhe një punonjësi të sigurisë operative?

6 Pë. Një punonjës apo oficer i sigurisë së dëshmitarit
7 përgjigjet për punën që bëjmë me dëshmitarët, kontaktet me
8 dëshmitarët, i mbështesin ata gjatë udhëtimeve derisa vijnë
9 tek vendi i intervistës. Kurse oficerët operativë të sigurisë
10 kujdesohen për sigurinë e stafit, për automjetet dhe për
11 sigurinë e organizatës.

12 Py. Faleminderit. Do t'ju pyes për zhvendosjen apo
13 transferimin. Më 28 tetor keni dëshmuar në mëngjes dhe
14 përmendët një person që ishte zhvendosur. Dhe pasdite thatë se
15 ishin dy të tillë që u zhvendosën, dy persona. Ju kujtohet?

16 Z. REES: Mund të shikojmë transkriptin në faqen 1762.

17 Z. PACE: Kjo referencë u përdor edhe për dëshmitarët e
18 tjerë në mëngjes, kështu që le të shikojë më mirë dokumentin
19 1708 që të ketë një ide më të qartë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Nuk ka
21 përkthim].

22 Z. REES: [Përkthim] Ta bëjmë ndryshe.

23 Py. Ju i thatë zotit Pace dhe Matt Halling gjatë seancës së
24 përgatitjes së dëshmitarëve më 14 tetor 2021 se një person u
25 zhvendos që lidhej me ngjarjet e shtatorit e 2020. Dhe këtu,

1 në faqen 1762 të transkriptit mund të shohim në rreshtin 25,
2 keni thënë që dy persona u zhvendosën.

3 Kush është e saktë: ajo që i thatë zotit Pace dhe Halling
4 se një person --

5 Pë. Nuk e mbaj mend që i kam thënë zotit Pace një person u
6 zhvendos.

7 Py. Duhet ta dijë z. Pace se ai e mbajti shënim dhe na e tha
8 edhe ne.

9 Prandaj po të pyes përsëri cila është e saktë: ajo që i
10 the zotit Pace se vetëm një person u zhvendos, apo ato që i
11 the Gjykatësit BARTHE se ishin dy?

12 Z. PACE: [Përkthim] U bë pyetja dhe mori përgjigje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet.
14 Mund të përgjigjeni.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] E vërteta është ajo që i thashë
16 Gjykatësit BARTHE, dy persona ishin që u zhvendosën.

17 Z. REES: [Përkthim]

18 Py. Mos po ekzagjeronit përsëri? Pra, mos po ekzagjeronit
19 përsëri?

20 Pë. A mund të më shpjegoni?

21 Py. Përgjigjuni pyetjes: Po ekzagjeron kur thua dy persona u
22 zhvendosën? Është pyetje e drejtpërdrejtë?

23 Z. PACE: [Përkthim] Nuk është përgjigje e drejtpërdrejtë.
24 Është e paqartë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i

1 përgjigjeni. E hoqi "përsëri".

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Dy persona u zhvendosën.

3 Z. REES: [Përkthim]

4 Py. Po të pyes, po ekzagjeroje ti kur the kështu?

5 Pë. Nuk e kuptoj pyetjen.

6 Py. Është një përgjigje [sipas përkthimit] që kërkon ose
7 "jo", ose "po", ose "nuk e di" si përgjigje. Kur the që dy
8 persona u zhvendosën, ekzagjerove?

9 Pë. Dy persona u zhvendosën.

10 Py. Në deklaratën e tetorit që keni dhënë, nuk keni thënë
11 asgjëkund se ZPS-së iu desh të zhvendoste ndonjë dëshmitar si
12 rrjedhojë e ngjarjeve të ndodhura në shtator të vitit 2020;
13 pajtoheni me këtë?

14 Pë. Po, pajtohem.

15 Py. Në deklaratën e janarit, nuk keni thënë asgjëkund se ZPS-
16 ja duhej të zëvendësonte, të zhvendoste ndonjë dëshmitar si
17 rezultat i ngjarjeve të shtatorit 2020; pajtohesh me këtë?

18 Pë. Pajtohem.

19 Py. Nga dy dëshmitarët që tani po thoni se u zhvendosën -- po
20 e ndaj që ta bëj më të qartë.

21 Lidhur me dëshmitarin, një dëshmitar që i treguat z. Pace
22 se u zhvendos, a është një person që ka të kaluar kriminale?

23 Pë. Asnjë person nuk është zhvendosur me të kaluar kriminale.

24 Py. Kjo vjen sepse ju e merrni parasysh kredibilitetin e tyre
25 kur bëhet një kërkesë për zhvendosje?

1 Pë. Ky është një nga kushtet për zhvendosje.

2 Py. Data kur ka ndodhur kjo zhvendosja, kur është?

3 Pë. Disa ditë.

4 Z. PACE: [Përkthim] Është kundërshtim i vonuar, por nuk
5 është pyetje e përshtatshme. Është shumë konkrete. Edhe në
6 qoftë se dëshmitari mund t'i përgjigjet, është shumë, nuk ka,
7 nuk është relevante.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet.
9 Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

10 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se dëshmitari do të
11 përgjigjet, ju lutem të kalojmë në seancë private, sepse
12 zhvendosja e një personi nga Kosova është një ngjarje që
13 kërkon konfidencialitet, që të mos tërheqë vëmendjen në një
14 seancë publike. Po të kalojmë në seancë publike [sipas
15 përkthimit] Mbrojtja do ta marrë përgjigjen.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokat.

17 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju e dini që unë
18 mendoj se gjërat duhen trajtuar në seancë publike.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por nuk e di
20 se ku do të dalësh me këto pyetje, kështu që do të dalë
21 informacion privat.

22 Z. REES: [Përkthim] Dua të shtjelloj me dëshmitarin
23 rrethanat kur ka ndodhur, sipas tij, zhvendosja, nëse ka të
24 bëjë me ngjarjet e shtatorit 2020. Dhe një nga tiparet e kësaj
25 do të jetë afërsia e zhvendosjes me ngjarjet e ndodhura në

1 shtator.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni i
3 çaktivizuar].

4 Z. REES: [Përkthim] Po --

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 125

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.

15 Z. REES: [Përkthim]

16 Py. Faleminderit zoti Jukiç. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

17 Megjithatë, si me dëshmitaren e mëparshme, zj. Pumper, a mund

18 të rezervoj pozicionin sa i takon, le të themi çështjeve që

19 kanë të bëjnë me nxjerrjen e informacionit, në qoftë se është

20 e mundur.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

22 Zoti Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, si rezultat i

24 marrjes në pyetje të hollësishme, unë e miratoj dhe i mbështes

25 të gjitha pyetjet të cilat janë bërë nga zoti Rees dhe do të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukiç (Vijon) ~~(Seancë private)~~

Faqe 133

Riklasifikuar si publike në F611/A3.

Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

1 doja që të thosha që jemi plotësisht dakord me të gjitha
2 pyetjet e bëra për këtë dëshmitar. Dhe, siç u tha edhe nga z.
3 REES, pastaj më pas mund të ngremë ndonjë pyetje pas nxjerrjes
4 së dokumenteve, siç u parashtrua edhe nga z. Rees.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
6 zoti Cadman.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni i
9 çaktivizuar].

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] E harrova tërësisht, domethënë,
13 mbase duhej të thosha të njëjtat gjëra në seancë publike. Nuk
14 e di nëse duhet ta them edhe njëherë atë që thashë në seancë
15 private.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju lutem,
17 thojeni edhe njëherë.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Si rezultat i marrjes se
19 hollësishme në pyetje të dëshmitarit nga z. Rees, neve jemi në
20 të njëjtën linjë me pozicionin e shprehur me z. Rees.
21 Pozicioni ynë është që provat vetë flasim, kanë zë dhe flasim
22 për vete. Ne duam që të rezervojmë të drejtën që ta
23 rithërrasim këtë dëshmitar për sa i takon pyetjeve të
24 mëtejshme, pasi të merret një vendim për nxjerrjen e
25 informacionit. Për momentin, nuk keni pyetje të tjera.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Nuk e di nëse ka pyetje të tjera?

3 Z. PACE: Po, por shumë shkurtimisht.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që

5 duhet që të pyesni vetëm për gjërat të cilat janë ngritur nga

6 avokati i mbrojtjes.

7 Pyetje vijuese nga Z. Pace:

8 Z. PACE: [Përkthim]

9 Py. Faleminderit, zoti dëshmitar.

10 Pë. Mirëdita, zoti Prokuror.

11 Py. Pak minuta më parë u përmend seanca përgatitore e

12 dëshmitarit dhe informacioni i caktuar që mbase ju e mbani

13 mend, ose jo.

14 Z. PACE: Dua që t'i referohem faqeve 123 dhe 124 të

15 transkriptit të ditës së sotme.

16 Py. Avokati i zotit Gucati ju pyeti në lidhje me zhvendosjet,

17 nëse kishte një zhvendosje ose dy zhvendosje dhe ju pyeti se

18 sa zhvendosje keni përmendur juve.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e vërej që lista

20 e përgatitjes së dëshmitarit nuk është provë. Megjithatë

21 çdokush këtu ka qasje në të, kështu që mund ta shikojë vetë

22 këtë paragraf dhe do të doja t'ju kërkoja që ta lexoni këtë

23 paragraf.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vijoni më

25 tej.

1 Z. PACE: [Përkthim]

2 Py. Atëherë, mbrojtja e zotit Gucati ju pyeti sa i takon
3 informacionit të ZPS-së që ju është dhënë lidhur me
4 përgatitjen për këtë seancë pasdite. Do të doja që të shikonit
5 dokumentin dhe do të doja që të lexoje nga dokumenti i
6 mëposhtëm.

7 "Pas shpërndarjes së paketave, siguria e dëshmitarëve të
8 ZPS-së mori masa në terren. Masa të tilla përfshinë një
9 zhvendosje, zhvendosjen e një personi në [REDAKTUAR] dhe
10 referimin e personave për mbrojtjen e dëshmitarëve."

11 Zoti dëshmitar, a ju duket e saktë kjo, lidhur me
12 informacionin që i keni dhënë ZPS-së? Këtu flasim konkretisht
13 për një zhvendosje dhe dikë tjetër, i cili është kaluar, është
14 vendosur në [REDAKTUAR]?

15 Pë. Po, është e saktë. Bëhet fjalë për dy persona.

16 Py. Sa për të qenë i qartë, zoti dëshmitar, sa i takon
17 zhvendosjes së dikujt në [REDAKTUAR], e bëni dallimin ju nga
18 rihvendosja, apo kemi të bëjmë me të njëjtën gjë në të dyja
19 rastet?

20 Pë. Është e njëjta gjë.

21 Py. Po në këtë shënim, pse e keni bërë këtë dallimin?
22 Domethënë, ti thua që ka një zhvendosje dhe kalim të dikujt në
23 [REDAKTUAR]. Pra, pse është bërë ky dallim?

24 Pë. Zhvendosja që është bërë, është që personi direkt është
25 marrë nga Kosova, është nxjerrë nga Kosova. Ndërkohë, sa i

1 takon zhvendosjes së dytë, personi është vënë së pari në një
2 [REDAKTUAR] e pastaj, në një moment të dytë, [REDAKTUAR] është
3 nxjerrë jashtë Kosovës.

4 Py. Faleminderit, zoti dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
6 z. Pace.

7 Zoti Gaynor.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim]

9 Pyetje nga Trupi Gjykses:

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të kuptoj më mirë një
11 shprehje që keni përdorur gjatë dëshmisë suaj. I referohem
12 specifikisht transkriptit të ditës së sotme që është në faqen
13 47 deri në 48. Shprehja "dëshmitar i dyshuar".

14 Tani dua t'ju pyes, a e përdorni shprehjen "dëshmitar i
15 dyshuar" në punën tuaj?

16 Pë. Jo, ne nuk e përdorim këtë fjalë.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e njihni, a e keni dëgjuar
18 ndonjëherë më përpara këtë shprehje, domethënë "dëshmitar i
19 dyshuar"?

20 Pë. Jo, kjo është hera e parë që e kam dëgjuar nga zoti
21 avokat sot.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A është e saktë që ju
23 merreni me ca dëshmitarë të cilët janë të dyshuar dhe
24 dëshmitarë të cilët nuk janë të dyshuar.

25 Pë. Po, ne trajtojmë dy kategori të dëshmitarëve.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kaq doja të sqaroja.

2 Faleminderit, zoti Jukiç.

3 Faleminderit, zoti Kryetar i Trupit Gjykses.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

5 METTRAUX, fjala për ju.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim]

7 Gjëja e parë që do të kërkohja është që Sekretaria të mund
8 të na tregojë faqen 27 të transkriptit të ditës së sotme.

9 Zoti Jukiç, dua t'i hidhni një sy kësaj faqeje, pa e
10 përmendur emrin e personit që përmendet aty.

11 Ju lutem, përqendrohuni tek faqja 27. Në faqen 27 juve ju
12 bëhet një pyetje specifikisht për këtë personin që përmendet
13 në këtë faqe dhe ju thoni, lidhur me këtë person, që ai
14 kontaktoi me zyrën dhe pastaj zyra kontaktoi me të.

15 A e mbani mend këtë, z. Jukiç?

16 Pë. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por, ndoshta, ju nuk keni
18 pasur kontakt personalisht me këtë individ, por dua t'ju pyes
19 në qoftë se ju jeni në dijeni nëse ky individ u ka thënë
20 kolegëve tuaj që ata kishin kontaktuar me të.

21 Pë. Unë jam në dijeni që ky individ ka qenë në kontakt me
22 ekipin e sigurimit të dëshmitarëve.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini që ky person, pra,
24 ka marrë në telefon ose ka vënë kontakt me juve për ndonjë
25 kërcënim, ose ndonjë gjë tjetër?

1 Pë. Unë kam dijeni vetëm nga notat zyrtare dhe nga disa
2 diskutime që janë bërë në takimet për ekipin e sigurisë së
3 dëshmitarëve.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë dini ju nga leximet
5 që keni bërë të këtyre Notave për këtë takim, për këtë takim
6 specifik me këtë individ?

7 Pë. Nuk e mbaj mend ekzaktësisht se çfarë ka thënë, por në
8 vija të përgjithshme, ai ankohej për publikimin e rrjedhjeve
9 të dokumentacionit.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me aq sa mbani mend ju, a
11 është marrë ndonjë masë, apo a janë marrë disa masa për sa i
12 takon këtij individ specifik?

13 Pë. ZPS-ja nuk ka marrë asnjë masë për ta mbrojtur këtë
14 individ konkret.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në faqen 51 dhe 54 të
16 transkriptit, zoti REES ju bën disa pyetje që kanë të bëjnë me
17 arsyet që mund ta bëjnë një dëshmitar që të humbi interesin
18 për të vijuar me bashkëpunimin e tyre ose me hetimet që mund
19 të kryejë zyra juaj.

20 A e mbani mend këtë pyetje?

21 Pë. Po, e mbaj mend.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në përvojën tënde si oficer
23 i mbrojtjes së dëshmitarëve, pra, a është ekspozimi i të
24 dhënave personale të një personi një shkak i mundshëm për ta
25 shkrajuar këtë person për të bashkëpunuar me ju ose për të

1 dhënë informacionin e vet për sa i takon hetimeve, ose
2 ndjekjes penale?

3 Pë. Nga përvoja ime, mund të them po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me aq sa dini ju, a ka
5 ndodhur kjo lidhur me rrjedhjen e informacionit të ndodhur në
6 shtator të 2020-s?

7 Pë. Po, kjo ka ndodhur gjatë këtij ushtrimi.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në atë që duket se është
9 tema më e pëlqyer e të gjithëve për zhvendosjen, sepse për
10 zhvendosjen t'u bënë pyetje nga të dyja palët, dua të të pyes
11 se në çfarë rrethanash zhvendosja konsiderohet e përshtatshme,
12 nga pikëpamja juaj, gjatë ushtrimit të detyrave që keni ju?

13 Pë. Ka disa kushte që duhet të përmbushen për të zhvilluar
14 zhvendosjen: numri një është kërcënimi; arsyeja e dytë është
15 deklarata e personit, apo gjendja e personit; dhe, së treti,
16 kushti tjetër është këto persona të përmbushin disa kushte për
17 ta zhvendosur atë dhe familjen e tij dhe ky element është
18 vullnetarizmi, domethënë, që të dalë vullnetar personi.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sërish, nuk duam që të
20 nxirrni ndonjë informacion konfidencial këtu, por do të doja
21 të dija se në çfarë procesi kalohet nga zyra juaj për të
22 këshilluar apo për të rekomanduar zhvendosjen? A është një
23 proces ky që përfshin disa njerëz, disa procedura, shumë zyra,
24 pra, për të përcaktuar nëse zhvendosja është e justifikuar në
25 raste të caktuara, apo jo? Apo thjesht merrni parasysht atë

1 çfarë thotë dëshmitari?

2 Pë. Në këtë proces merr pjesë një prokuror, hetues, por
3 gjithashtu edhe oficerët e mbrojtjes së dëshmitarëve që
4 përgatisin një propozim për Prokurorin e Specializuar. Nëse
5 Prokurori i Specializuar vendos se ky person mund të referohet
6 për arsye zhvendosjeje, atëherë ne vijojmë me përgatitjen e
7 referimit në mënyrë që të mund t'i përfshijmë këto persona në
8 programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, domethënë në Regjistrin
9 e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
12 Barthe ka një pyetje.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim]

14 Kam një pyetje që ka të bëjë me telefonatat ose personat
15 që janë kontaktuar prej jush, apo kolegëve tuaj në shtator të
16 2020-ës, apo pas shtatorit të 2020-ës. Unë nuk dua që të flas
17 për komentin që bëri zoti Rees sa i takon shifrave, sa të
18 sakta apo jo janë ato.

19 Megjithatë, për çështje qartësie, zoti Jukiç, ju
20 përmendët që kanë qenë rreth 200 persona të cilët kanë marrë
21 telefonata prej jush. Sa dëshmitarë janë marrë me një thirrje
22 telefonike? Domethënë, do të doja të dija, në mënyrë më
23 precize, keni folur me një person gjatë një bisede telefonike,
24 apo me më shumë se një person?

25 Pë. Ne asnjëherë nuk kemi folur me më shumë se një person në

1 një bisedë telefonike.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka ndodhur që ju të keni
3 marrë, apo të keni folur me të njëjtin person ose me të
4 njëjtin më shumë se një herë, pra, ta keni marrë disa herë?
5 Pë. Po, ka ndodhur gjatë këtij ushtrimi disa herë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani, zoti Jukiç, a mund të
7 jetë që ju dhe kolegët tuaj të keni bërë më shumë se 200
8 biseda telefonike në shtator 2020 dhe më pas?

9 Pë. Po, është e mundur.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë, kjo shifra 200
11 telefonata është shifër minimale, apo maksimale?

12 Pë. Është rreth 200. Nuk mund të them me siguri.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, mund të jenë edhe më
14 shumë se 200, apo jo?

15 Pë. Po, mund të jenë dhe më shumë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A kemi pyetje
18 të tjera për këtë dëshmitar?

19 Jo, nuk kemi.

20 Zoti Jukiç, faleminderit që ishit me ne sot. Sekretarja e
21 seancës do të të shoqërojë jashtë sallës së gjyqit.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

23 [Dëshmitari largohet]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Rees.

25 Z. REES: [Përkthim] A mund të them diçka për sa i takon

1 ëshmitarëve të dyshuar, sigurisht nga mënyra se si e kemi
2 kuptuar ne provën dhe kjo do të reflektohet edhe në
3 transkript? Por me aq sa kuptova unë, dëshmitari na tha që
4 ishte i informuar që ZPS-ja kishte dërguar fletëthirrje për
5 persona të cilët donte t'i intervistonte si dëshmitarë të
6 dyshuar.

7 Është e vështirë, në fakt, që të përshkruash apo të
8 shpjegosh se çfarë kuptimi ka ky koncept dhe për këtë arsye
9 edhe unë u gjeta në mënyrë të vështirë në momentin kur i
10 nderuari Gjyqtar më pyeti që të shpjegoja konceptin. Por nuk
11 ka dyshim lidhur me këtë që, në fakt, dëshmitari na tha që
12 ishte në dijeni të faktit që janë marrë fletëthirrje nga
13 dëshmitarët e dyshuar.

14 Kjo, ndoshta është diçka e cila mund të trajtohet në
15 kuadrin e fakteve të rëna dakord. Ata të cilët më ndihmojnë
16 mua do të flasin me anëtarët e ZPS-së në mënyrë që të arrijnë
17 në disa fakte të pajtuara, të dakorduara për sa i takon
18 analizës së notave të kontaktit të dëshmitarëve ose të titujve
19 që përdoren në marrjen në pyetje. Besoj që kjo mund të
20 ndihmonte edhe Trupin Gjykues.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne ju
22 inkurajojmë që të bini dakord dhe, sigurisht, që ju
23 inkurajojmë sërish.

24 Z. PACE: [Përkthim] Pa diskutim, ne jemi të gatshëm të
25 bashkëpunojmë, por unë nuk e kam dëgjuar dhe nuk e di se nga

1 ka dalë ky termi i "dëshmitarëve të dyshuar".

2 Dhe, siç e di edhe Trupi Gjykues, ne kemi kërkuar
3 pranimin e këtyre notave, pavarësisht se çfarë thonë ata dhe
4 pavarësisht në qoftë se ata dëshmojnë një kërcënim apo jo.

5 Në qoftë se Mbrojtja pajtohet që të gjitha këto nota të
6 pranohen, ne nuk kemi ndonjë kundërshtim me këtë. Megjithatë,
7 nuk mendoj që në qoftë se do të angazhohemi më shumë në këtë
8 çështje do të sillte ndonjë vlerë të shtuar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni i
10 çaktivizuar].

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një gjë
12 para se të përfundojmë.

13 Dua t'ju informoj të gjithëve që do të ketë një kërkesë
14 konfidenciale urgjente sot pasdite. Pasi të merret kjo
15 kërkesë, dua që të dyja palët të më thonë me email sot nëse
16 kanë kundërshtim për këtë kërkesë, apo jo. Në qoftë se ka
17 kundërshtime, këto kundërshtime do t'i dëgjojmë nesër paradite
18 përpara se të fillojmë me dëshmitarin nesër.

19 Ky është i gjithë informacioni që mund t'ju jap për
20 momentin.

21 Z. Rees, edhe një gjë. Ne ishim ende në seancë private
22 kur thatë që nuk keni pyetje të tjera. Kam përshtypjen se mund
23 të thoni tani që nuk keni pyetje të tjera.

24 Mikrofonin.

25 Z. REES: Unë e kam mbaruar marrjen në pyetje të

1 dëshmitarit lidhur me pyetjet që kam deri në këtë moment dhe
2 ju kam kërkuar, të nderuar Gjykatës, që të më lejoni mundësinë
3 që të bëj pyetje të tjera në të ardhmen për të njëjtin
4 dëshmitar, në qoftë se do të më dalin pyetje si rezultat i
5 nxjerrjes së informacionit të dokumenteve.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, jua
7 pranojmë këtë kërkesë, nëse do të nevojitet që të rithërrasim
8 sërish të njëjtin dëshmitar për pyetje që mund të dalin nga
9 nxjerrja e dokumenteve në të ardhmen.

10 Z. REES: [Përkthim] [Nuk ka përkthim].

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, nuk
12 ju vura re që ishit ngritur në këmbë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka problem. Përderisa thatë që
14 mund të dorëzojmë kundërshtimin për kërkesën gjatë ditës së
15 sotme, duhet të them që ne nuk kemi ndonjë gjë për të shtuar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj
17 këtë. Dhe, ju lutem, nëse keni kundërshtim për kërkesën, na
18 thoni gjatë ditës së sotme.

19 Kemi përfunduar. Faleminderit dhe do të fillojmë nesër në
20 orën 09:30.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, të gjithë në
22 këmbë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di tani që
24 dokumenti është dorëzuar. Kështu që do të do të njoftoheni
25 menjëherë.

1 --- Seanca mbyllet në orën 15.56

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25